



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

“Procedura për lidhjen e martesës dhe regjistrimi në librat amzë të të kurorëzuarve sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës me fokus në komunën e Kaçanikut për periudhën 2012-2022”

KANDIDATJA:

Shqipe CEKA

MENTOR:

Doc.Dr. Albana METAJ-STOJANOVA

Nëntor, 2023

Përmbajtja:

Hyrja.....	9
QËLLIMET E HULUMTIMIT	10
HIPOTEZAT	11
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	12
RËNDËSIA E PUNIMIT.....	13
KAPITULLI I PARË	14
1. NOCIONI, ZHVILLIMI HISTORIK, KUPTIMI DHE NATYRA JURIDIKE E MARTESËS.....	14
1.1 Nocioni i martesës	14
1.2 Kuptimi i institutit të martesës.....	18
1.3 Zhvillimi historik i martesës.....	18
1.3.1 Lidhja e martesës në të drejtën romake	19
1.3.2 Lidhja e martesës në të drejtën zakonore shqiptare	21
1.3.3 Lidhja e martesave në kohën bashkëkohore.....	23
1.4 Natyra juridike e institutit të martesës.....	24
1.5 Parimet e të drejtës martesore.....	25
KAPITULLI I DYTË	28
2. KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESËS DHE PROCEDURA PËR LIDHJEN E MARTESËS ...	28
2.1 Kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj	28
2.1.1 Lidhja e martesës nga bashkëshortët me sekse të kundërta	29
2.1.2 Pajtimi i vullneteve të bashkëshortëve për lidhjen e martesës	30
2.1.3 Forma për lidhjen e martesës	31
2.1.4 Mosha madhore e bashkëshortëve	32
2.2 Pengesat martesore	33
2.2.1 Martesa ekzistuese (bigamia).....	34
2.2.2 Mosha e mitur dhe instituti i emancipimit	35
2.2.3 Sëmundja e rëndë psikike ose zhvillimi i metë mendor	36
2.2.4 Lidhja gjinore midis bashkëshortëve	37

2.2.5 Të metat në shfaqjen e vullnetit	38
2.3 Procedura për lidhjen e martesës (kurorëzimit)	38
2.3.1 Procedura paraprake.....	41
2.3.2 Lidhja e martesës përpara organit kompetent	43
DEKLARATË SOLEMNE ME RASTIN E LIDHJES SË MARTESËS.....	44
2.4 Regjistrimi i kurorëzimeve në librat amzë.....	48
KAPITULLI I TRETË	50
III. TË DHËNA MBI MARTESAT E LIDHURA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT NË PERIUDHËN 2012-2022	50
3.1.1 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2012	50
3.1.2 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2013	52
3.1.3 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2014	54
3.1.4 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2015	56
3.1.5 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2016	58
3.1.6 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2017	60
3.1.7 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2018	62
3.1.8 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2019	64
3.1.9 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2020	66
3.2 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2021	68
3.2.1 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2022	70
3.2.2 Numri i kurorëzimeve sipas viteve.....	72
3.2.3 Mosha e mesatare e meshkujve sipas viteve.....	73
3.2.4 Mosha e mesatare e femrave sipas viteve.....	74
3.2.5 Mesatarja e kurorëzimeve sipas viteve.....	75
KAPITULLI I KATËRT	76
IV. DISKUTIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE	76
Bibliografia:	81

Abstrakt

Në këtë punim, kemi trajtuar një problematikë mjaft të rëndësishme për të rinjtë e qytetit të Kaçanikut, lidhjen e martesave, si akti biologjik dhe juridik më i rëndësishëm pas lindjes. Prandaj, kujdesi gjatë përzgjedhjes së bashkëshortit dhe të bashkëshortes nuk është me rëndësi vetëm për lumturinë e vetë çiftit bashkëshortor, por edhe për vazhdimësinë dhe stabilitetin e mbarë familjes dhe shoqërisë.

Martesat kanë ekzistuar prej kohës që ka ekzistuar njerëzimi, por realizmi i këtyre martesave është bërë në forma të ndryshme. Martesat e hershme janë ende të pranishme në vendin tonë. Traditat dhe zakonet tek komunitetet e ndryshme vazhdojnë të aplikohen në mënyrë të njëjtë, pa pësuar ndryshime. Ato, konsiderohen shkelje të të drejtave të njeriut dhe dhunë me bazë gjinore. Këto martesat, janë përcaktuar si kurorëzim i dy personave ku njëra ose të dy palët janë nën moshën 18 vjeçare. Mirëpo, me kalimin e kohës, dhe me zhvillimin e shoqërisë dhe ngritjen e vetëdijes qytetare, kohëve të fundit është bërë përparim në këtë drejtim. Krahas vetëdijesimit qytetar, edhe shtetet janë përkujdesur për ta avancuar këtë çështje, duke e rregulluar që martesat të bëhen sipas akteve normative, dhe duke i penguar martesat që janë bërë në të kaluarën, pa mbështetje institucionale. Në kohën e tashme, martesat mund të themi se është institucion shoqëror i cili gëzon njohje ligjore. Pra, kuptimi themelor i martesës është ndërtimi i një familje, në mënyrë që t'u jap legjitimitet fëmijëve të lindur ose të adoptuar gjatë bashkimit. Sot, martesat bëhen në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile. Sipas Hulumtimit që e kemi bërë në qytetin e Kaçanikut, për periudhën 2012-2022, rezulton që qytetarët e këtij qyteti, kurorëzimet i kanë bërë në pajtim të plotë me këto dispozita ligjore, ku, gjatë kësaj periudhe, në këtë qytet, sipas librit amzë të komunës, janë realizuar gjithsej 1614 kurorëzime. Nga këto kurorëzime, pas analizimit dhe përpunimit të rezultateve, është zbuluar se mosha mesatare e meshkujve është 30.4 vjeç, ndërsa mosha mesatare e femrave është 26.8 vjeç. Ndërkaq, mosha mesatare e të kurorëzuarve është 28.5 vjeç. Prej këtij hulumtimi, gjithashtu kemi zbuluar se gjatë kësaj periudhe, janë bërë 5 raste të lidhjes së martesës që janë në kundërshtim me kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj. Tri raste janë në vitin 2012, një në vitin 2015 dhe një në vitin 2016. Në të gjitha rastet, personi i gjinisë femërore ka qenë nën moshën 18 vjeçare. Dhe, të gjitha këto raste, janë vendosur me vendim të gjykatës.

Fjalë kyçe: familje, lidhja e martesës, libri amzë, mosha mesatare

Апстракт

На ова теза, сме изработиле една многу важна проблематика за младите на градот Качаник, склучувањето на бракот, кој е најважен биолошки и правен акт после раѓањето. Затоа, грижата при изборот на брачниот другар не е одлучувачка само за среќата на самиот брачен пар, туку и за континуитетот и стабилноста на семејството и општеството. Бракот постои од времето кога постои човештвото, но склучувањето на овие бракови е спроведено во различни форми. Раните бракови, односно, склучувањето на бракот кај младите, малолетни лица, е сеуште присутно во нашата земја. Традициите и обичаите во различни заедници продолжуваат да се применуваат на ист начин, без да претрпат промени. Тие се сметаат како загрозување на правата на граѓаните и родово базирано насилство. Овие бракови се определени како склучување брак на две лица, од каде едното лице или двајцата се под 18 годишна возраст. Меѓутоа, со тек на времето и со развојот на општеството и свеста на граѓаните, неодамна е постигнат напредок во оваа насока. Освен свеста на граѓаните и државите се потрудиле да го осовршуваат оваа прашање, регулирајќи го тоа браковите да се склучуваат според нормативните акти, за да се спречат браковите што биле склучени во минатото без никаква институционална поддршка. Во моментот, може да кажеме дека бракот е општествена институција која ужива законско признавање. Значи, основното значење на бракот е да се изгради семејство, за да се даде легитимитет на децата родени или посвоени за време на заедницата. Денес, браковите се одвиваат во целосна согласност со законските одредби на граѓанскиот статус. Истражувањето што го направивме во градот Качаник, за периодот 2012-2022 година, покажува дека граѓаните на овој град склучувањата на бракови ги направиле целосно почитувајќи ги овие законски одредби. Во овој период, во овој град, според Општинскиот Регистар, се склучени 1614 бракови. Од овие бракови, по анализа и обработка на резултатите, откриено е дека просечната возраст на мажите е 30,4 години, додека просечната возраст на жените е 26,8 години. Во меѓувреме, просечната возраст на брачните партнери е 28,5 години. Од ова истражување откривме и тоа дека во овој период имало 5 случаи на бракови кои се спротивни на условите за склучување на брак и неговата важност. Три случаи биле во 2012 година, еден во 2015 година и еден во 2016 година. Во сите случаи, женското лице било на возраст под 18 години. И сите овие случаи се решавани по судски одлуки.

Клучни зборови: семејство, склучување на брак, матична книга, просечна возраст

Abstract

In this paper, we have addressed a very important problem for the young people of the city of Kaçanik, the marriage, as the most important biological and legal act after birth. Therefore, cautiousness during the selection of a husband and wife is not only important for the happiness of the married couple, but also for the continuity and stability of the entire family and society. Marriages have existed for as long as mankind has existed, but the reality of these marriages has come in different forms. Early marriages are still present in our country. Traditions and customs in different communities continue to be applied in the same way, without undergoing changes. They are considered violations of human rights and gender-based violence. These marriages are defined as the coronation of two people where one or both parties are under the age of 18. However, with the passage of time, and with the development of society and the rise of civic awareness, progress has recently been made in this direction. In addition to citizen awareness, the countries have also taken care to advance this issue, regulating marriages to be made according to normative acts, and preventing marriages that were made in the past, without institutional support. At the present time, we can say that marriage is a social institution that has a legal recognition. Hence the basic meaning of marriage is to build a family, in order to give legitimacy to the children born or adopted during the union. Today, marriages take place in full accordance with the legal provisions of civil status. The research we have done in the city of Kaçanik, for the period 2012-2022, results that the citizens of this city have done the coronations in full compliance with these legal provisions. Where, during this period, in this city, according to the municipality's register, 1614 coronations were performed. From these coronations, after analyzing and processing the results, it was discovered that the average age of men is 30.4 years, while the average age of women is 26.8 years. Meanwhile, the average age of those crowned is 28.5 years. From this research, we have also discovered that during this period, there were 5 cases of marriages that are contrary to the conditions for marriage and its validity. Three cases were in 2012, one in 2015 and one in 2016. In all cases, the female person was under the age of 18. And all these cases have been decided by court decision.

Key words: *family, marriage, marriage records, average age*

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Shqipe Ceka nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: "Procedura për lidhjen e martesës dhe regjistrimi në librat amzë të të kurorëzuarve sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës me fokus në komunën e Kaçanikut për periudhën 2012-2022", është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Shqipe Ceka

FALENDERIME

Shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë ata që më kanë përkrahur e ndihmuar, nga afër apo prej së largu, në kryerjen e këtij punimi. Falënderoj veçanërisht udhëheqësen time, Doc. dr. Albana Metaj-Stojanova, që pranoi të më udhëhiqte në këtë ndërmarrje vendimtare të formimit tim, pa kursyer ndihmën, mbështetjen, besimin, dhe mbi të gjitha këshillat e saj me vlerë për realizimin e këtij punimi, si dhe në veçanti për motivimin e lartë dhe kurajën në nivel personal për finalizimin e këtij punimi. Gjithashtu, një falënderim më i madh shkon për familjen time, të cilët më kanë qëndruar pranë me devotshmëri, më kanë dhënë mbështetjen e tyre maksimale, duke ma lehtësuar punën akademike përmes sakrificës dhe mirëkuptimit. Mirënjohje e veçantë shkon për universitetin dhe për mundësinë e ofruar, si dhe për të gjithë pedagogët me të cilët kam pasur kënaqësinë të ndajmë së bashku orët e leksioneve, duke na u përkushtuar në maksimum.

Hyrja

Lidhja e martesës është një prej momenteve më të rëndësishme në jetën e njeriut, pas lindjes dhe vdekjes. Gjithherë, lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne dhe botërisht, në praninë e personave zyrtarë, të dhëndrit dhe nuses dhe me prezencë të publikut. Martesa është burim kryesor i familjes. Po ashtu, lidhja e martesës është bashkim juridik i dy personave të gjinive të ndryshme, të cilët synojnë një jetesë të përbashkët dhe realizim të përbashkët të interesave personalë dhe pasurorë, duke formuar kështu një bashkësi në drejtim të kontributit dhe mbarëvajtjes së familjes. Lidhja e martesës sjell për bashkëshortët një sërë të drejtash dhe detyrimesh. Tërësia e të drejtave dhe detyrimeve përfaqësojnë përmbajtjen e marrëdhënies martesore. Këto të drejta e detyrime në masë të madhe janë rregulluar me norma urdhëruese nga Ligji për Familjen i Kosovës. Në këto rrethana, bashkëshortët nuk mund t'i shmangen përmbushjes së tyre, as me marrëveshje ndërmjet tyre, e aq më pak nëpërmjet vullnetit të njëanshëm të njërit bashkëshort.

Në të kaluarën, lidhja e martesës dhe kurorëzimi nuk kanë pasur të njëjtin rregullim ligjor që kanë sot. Kanë ndodhur shumë ndryshime që nga koha e të drejtës romake, apo e të drejtës zakonore shqiptare në aspektin e lidhjes së martesës. Martesat bashkëkohore lidhen sipas legjislacionit në fuqi, sipas një procedure të përcaktuar me ligj, në praninë e organit kompetent zyrtar, ku duhet patjetër të jenë prezentë edhe burri edhe gruaja, si dhe dy dëshmitarë. Rregullimi i lidhjes së martesës në Republikën e Kosovës, përveç Ligjit për Familje të Kosovës, parashikohet dhe nga ligje të tjera të posaçme, si Ligji për Gjendjen Civile, por edhe nga disa udhëzime administrative që rregullojnë këtë fushë, ndërsa në komunën e Kaçanikut parashikohet edhe nga Statuti i Komunës së Kaçanikut.

Gjatë punimit të kësaj teze të magistraturës, lëndë hulumtimi padyshim do të jenë lidhja e martesës, procedura e kurorëzimit dhe librat amzë në Komunën e Kaçanikut, për çiftet që dëshirojnë ta zyrtarizojnë lidhjen e martesës para organeve kompetente, përkatësisht në Zyrën e Gjendjes Civile. Këto lidhje bëhen pasi të plotësohet dokumentacioni i kërkuar, sipas akteve normative dhe çdo lidhje martesore regjistrohet në librin amzë të të kurorëzuarve. Vlen të theksohet se në Republikën e Kosovës, lidhja e martesave deri në vitin 2012, është shënuar me dorë në librin amzë, ndërsa prej vitit 2013, kemi përparim në këtë drejtim, sepse regjistrimet bëhen në formë elektronike dhe formohet akti i martesës. Që do të thotë se të gjitha të dhënat

personale nga regjistrat fizikë, përmes proceduarave së kalimit nga zyrtari i autorizuar i gjendjes civile, janë regjistruar në regjistrin elektronik. Ky regjistër tashmë mundëson lëshimin e të gjitha dokumenteve të gjendjes civile.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të bëjë një analizë thelbësore të institutit të martesës, duke u fokusuar tek kushtet thelbësore për lidhjen e martesës, pengesat martesore, si dhe tek procedura për lidhjen e martesës e rregulluar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës. Ky hulumtim e vendos theksin tek lidhjet e martesave të bashkëshorteve, dhe regjistrimin e tyre në librin amzë të kurorëzuarve në Komunën e Kaçanikut, për periudhën 2012-2022, gjithnjë duke e respektuar legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Në fillim, gjatë shtjellimit të këtij punimi, do të përshkruhet edhe zhvillimi historik i martesës, si një institut kryesor i së drejtës familjare, por edhe i së drejtës në përgjithësi, duke filluar nga martesë në të drejtën romake, martesë në të drejtën zakonore shqiptare, e rregulluar me normat zakonore të kanuneve të ndryshme, e deri tek martesë bashkëkohore që njohim sot. Do të analizohet gjithashtu natyra juridike e martesës dhe parimet kryesore të së drejtës martesore bashkëkohore. Në punim me detaje do të pasqyrohet dhe procedura e lidhjes së martesës në Republikën e Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është grumbullimi, analizimi dhe krahasimi i të dhënave që burojnë nga zyra e gjendjes civile, për të vërtetuar hipotezën e paraqitur në fillim të këtij punimi hulumtues. Pas grumbullimit të rezultateve për lidhjet e martesave dhe librat amzë nga të kurorëzuarit në Komunën e Kaçanikut për periudhën e lartcekur, do të bëjmë krahasimin e këtyre rezultateve mes viteve, duke zbuluar saktë numrin e zyrtarizmit të lidhjeve martesore dhe do të mundohemi të bëjmë edhe ndonjë krahasim me ndonjë komunë tjetër të Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet, se gjatë këtij hulumtimi, duke zbuluar numrin e martesave të lidhura dhe të regjistruar në librat amzë brenda periudhës së caktuar, do të zbulojmë edhe një variabël shumë të rëndësishme për këto lidhje, atë të moshës në mes bashkëshortëve, sepse në shumicën e rasteve edhe pse nuk kanë pengesa ligjore, lidhjet martesore nuk po zyrtarizohen me kohë.

HIPOTEZAT

Hipoteza kryesore e këtij punimi është:

- Numri i martesave të lidhura dhe të regjistruara në librin amzë të të kurorëzuarve në komunën e Kaçanikut ka varjuar në vite, duke pasur herë trende zbritëse e herë rritëse për periudhën e marrë në shqyrtim, nga viti 2012-2022.

Hipoteza ndihmëse e këtij punimi është:

- Mosha madhore e bashkëshortëve është një nga kushtet thelbësore për lidhjen e martesës, megjithatë ka dhe raste të lidhjes së martesës nga personi i mitur i moshës 16-18 vjeç.

Në këtë punim do të shtrohen pyetje kërkimore të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi në mënyrë joshteruese, të tilla si:

- Çka është nocioni i martesës?
- Cili është kuptimi dhe natyra juridike e institutit të martesës?
- Si ka evoluar lidhja e martesave që nga e drejta romake e deri në martesën bashkëkohore ?
- Si është bërë lidhja e martesave në të drejtën zakonore shqiptare?
- Cila është procedura e lidhjes së martesës në Republikën e Kosovës ?
- Cilat janë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve që janë të parashikuara nga akte të tjera normative?
- Sa është numri i të kurorëzuarave në komunën e Kaçanikut, për periudhën hulumtuese?
- Sa është mosha mesatare e bashkëshortëve gjatë lidhjeve të martesave?
- Sa është numri i personave të mitur që kanë lidhur martesë në bazë të institutit të emancipimit?

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Gjatë hulumtimit të kësaj teze të magistraturës, do të përdorim disa metoda për realizimin e saj, të cilat do të jenë:

Mbledhja dhe përpunimi i literaturës - Ky hap ka të bëjë me rishikimin e literaturës në lidhje me objektin e punimit. Këtu përfshihet identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, artikujve shkencorë të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën ligjore në përgjithësi dhe në fushën e temës në veçanti.

Analiza e legjislacionit – Në këtë punim do të mbështetemi në metodën e analizës dhe sintezës. Metoda ka të bëjë me formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në sistemin tonë juridik, normat ligjore që rregullojnë tematikën në fokus të punimit gjenden në Ligjin për Familjen i Kosovës dhe në ligje të tjera. Metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjedhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Metoda e analizës së legjislacionit është përdorur për interpretimin e dispozitave ligjore referuar të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga lidhja e martesës.

Metoda sasimore – përmes kësaj metode do të bëhet mbledhja, grumbullimi dhe analizimi i rezultateve të hulumtimit.

Metoda komparative – do të përdoret pas grumbullimit e të dhënave, sepse përmes kësaj metode do të bëjmë krahasimin e këtyre të dhënave sipas viteve dhe moshës për lidhjen e martesave të të kurorëzuarve në këtë komunë për periudhën hulumtuese.

Metoda doktrinare - do të përdoret për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme.

Metoda historike – Shfrytëzimi i kësaj metode ka për qëllim paraqitjen e evoluimit të institutit të martesës duke filluar nga e drejta romake, e drejta zakonore shqiptare e deri në ditët tona.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Me këtë punim synojmë të japim një kontribut të vlefshëm në trajtimin e tematikës së lidhjeve martesore dhe administrimit të librave amzë të të kurorëzuarave në komunën e Kaçanikut për dekadën e fundit, duke aplikuar aktet normative të Republikës së Kosovës, për këtë fushë. Rëndësia kryesore e këtij punimi konsiston në nxjerrjen e numrit të saktë të lidhjeve të martesave që janë bërë para organit kompetent, përkatësisht në Zyrën e Gjendjes Civile, duke bërë zyrtarizmin në librin amzë të të kurorëzuarave të kësaj komune. Gjithashtu, me shumë rëndësi është edhe eksplorimi i moshës së të kurorëzuarave në qytetin e Kaçanikut, për periudhën dhjetëvjeçare, sepse në disa raste paraqiten pengesa të ndryshme për zyrtarizmin e këtyre martesave dhe po krijohen vonesa të pa nevojshme, pra krahas numrit të lidhjeve të martesave sipas librit amzë, do të kemi edhe një variabël tjetër, atë të moshës mesatare të bashkëshorteve në këto lidhje.

Familja është një nocion mjaft i vjetër, që ka ekzistuar që nga fillesat e njerëzimit. Martesa vazhdon të ngelet baza kryesore e krijimit të familjes. Kujdesi gjatë përzgjedhjes së bashkëshortit dhe të bashkëshortes nuk është me rëndësi vetëm për lumturinë e vetë çiftit bashkëshortor, por edhe për vazhdimësinë dhe stabilitetin e mbarë familjes e shoqërisë. Njohja dhe realizimi i të drejtave dhe detyrimeve martesore nga ana e bashkëshortëve ndikon në ruajtjen e harmonisë dhe mirëkuptimit në marrëdhëniet bashkëshortore e familjare, ndërsa mos realizimi i të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortore shpesh herë çon deri në shkurorëzim të martesës.

Në këtë punim do të shqyrtohen në mënyrë të detajuar kushtet thelbësore për lidhjen e martesës, të cilat janë kushtet pozitive, që duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës, si dhe do të analizohen pengesat martesore, që janë rrethana negative, pra që nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Do të analizohet dhe procedura e lidhjes së martesës, si dhe roli dhe kompetencat e nëpunësit të gjendjes civile që kryen procedurën solemne të lidhjes së martesës.

Gjithsesi, një kontribut i rëndësishëm i këtij punimi hulumtues do të jetë edhe pasqyra reale e lidhjeve martesore të zyrtarizuara përmes organit kompetent në librin amzë të të kurorëzuarave në komunën e Kaçanikut, ngase përmes këtij akti marrin obligimet dhe detyrimet ndaj njëri tjetrit bashkëshortët.

KAPITULLI I

1. NOCIONI, ZHVILLIMI HISTORIK, KUPTIMI DHE NATYRA JURIDIKE E MARTESËS

1.1 Nocioni i martesës

Familja është një nocion mjaft i vjetër, që ka ekzistuar që nga fillesat e njerëzimit dhe deri sot, dhe ekzistojnë shumë përkufizime të ndryshme për familjen. Në fakt, familja dhe martesë janë struktura natyrore para-ligjore dhe para-shtetërore, të cilat e kanë shoqëruar njerëzimin që nga fillesat e tij e deri në ditët tona.¹

Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 16/3), familja është njësia themelore dhe natyrore e shoqërisë dhe *“Burri dhe gruaja, në një moshë të caktuar, pa dallim nga raca, kombësia, besimi, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje.”*

Gjithashtu, kemi shumë nocione të shumta dhe të ndryshme për familjen dhe martesën, si p.sh., familja është njësia shoqërore më e vogël e përbërë nga dy ose më shumë persona të cilët kanë midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi, që jetojnë në të njëjtin mjedis për një kohë relativisht të gjatë, kanë marrëdhënie kulturore dhe ekonomike të përbashkëta, si dhe përkujdesen për njëri-tjetrin.²

Përveç teoricienëve të ndryshëm që japin nocione të ndryshme për familjen dhe martesën, ekzistojnë edhe aktet normative në të gjitha shtetet e botës që i rregullojnë të drejtat familjare dhe të drejtat martesore me përgjegjësitë që ju takojnë bashkëshortëve dhe varësisht nga shteti mund të kemi edhe nocione të ndryshme për këto dy çështje.

Nocioni i familjes është i përcaktuar me aktet ligjore të shteteve përkatëse. Një të tillë e kemi nga aktet normative të Republikës së Kosovës, sipas së cilës familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje.³

Ndërsa, martesë vazhdon të ngelet baza kryesore e krijimit të familjes, si akti biologjik dhe juridik më i rëndësishëm pas lindjes. Martesë është një institucion social vital, në të cilin nuk realizohen vetëm interesat e bashkëshortëve dhe të familjes, por edhe interesa më të gjera shoqërore. Martesë është një institucion me karakter të dyfishtë: social dhe juridik. Nga njëra anë, martesë

¹ Albana Metaj-Stojanova, *The fundamental human right to marry and to family life and their protection in the legal framework of the Republic of Macedonia*, in *Iliria International Review*, Vol. 7, no. 1, Prishtinë, 2017

² <https://sq.wikipedia.org/wiki/Familja>, 20. 07.2023

³ Ligji për Familjen i Kosovës, neni 2

përbën bazën juridike kryesore për krijimin e familjes, dhe nga ana tjetër, familja përbën njësinë bazë dhe më të rëndësishme të shoqërisë. Është e padiskutueshme lidhja organike midis familjes dhe shoqërisë.⁴ Gjithsesi që, kujdesi gjatë përzgjedhjes së bashkëshortit dhe të bashkëshortes nuk është me rëndësi vetëm për lumturinë e vetë çiftit bashkëshortor, por edhe për vazhdimësinë dhe stabilitetin e mbarë familjes e shoqërisë. Njohja dhe realizimi i të drejtave dhe detyrimeve martesore nga ana e bashkëshortëve ndikon në ruajtjen e harmonisë dhe mirëkuptimit në marrëdhëniet bashkëshortore e familjare, ndërsa mos realizimi i të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortore shpesh herë çon deri në shkurorëzim të martesës.

Martesat kanë ekzistuar prej kohës që ka ekzistuar njerëzimi, por realizmi i këtyre martesave është bërë në forma të ndryshme. Martesat e hershme janë ende të pranishme, në vendin tonë. Traditat dhe zakonet tek komunitetet e ndryshme vazhdojnë të aplikohen në mënyrë të njëjtë, pa pësuar ndryshime. Martesat e hershme konsiderohen shkelje të të drejtave të njeriut dhe dhunë në bazë gjinore.

Martesa e hershme, përcaktohet si kurorëzim i dy personave ku njëra ose të dy palët janë nën moshën 18 vjeçare. Megjithatë, fenomenin e martesave të hershme më shpesh e hasim tek vajzat. Shkaktarët e shpeshtë të martesave të hershme vlerësohen të jenë mendësia patriarkale, tradita, feja, presioni shoqëror për vajzat që të martohen sa më herët dhe varfëria. Për një familje të varfër, vajza e re edhe mund të konsiderohet si barrë ekonomike. E në raste të caktuara ka ndodhur që familja merr një vlerë të caktuar monetare nga martesa e fëmijës. E gjithë kjo sigurisht është jo e drejtë dhe sjell pasoja të rënda në jetën e vajzave që martohen në moshë të re. Disa prej pasojave përfshijnë dhunën në familje, duke përfshirë këtu edhe izolimin nga shoqëria dhe familja, më pas divorci, shtatzënia e paplanifikuar, komplikimet gjatë shtatzënisë, ndërprerja e shkollimit dhe vështirësitë për qasje në punësim. Mirëpo, me kalimin e kohës, dhe me zhvillimin e shoqërisë dhe ngritjen e vetëdijes qytetare, kohëve të fundit është bërë përparim në këtë drejtim. Krahas vetëdijesimit qytetar, edhe shtetet janë përkujdesur për ta avancuar këtë çështje, duke e rregulluar që martesat të bëhen sipas akteve normative, dhe duke i penguar martesat që janë bërë në të kaluarën, pa mbështetje institucionale.

Martesa mund të pranohet si bashkimi midis dy personave, qoftë një burrë dhe një grua apo dy persona të të njëjtit seks, i cili krijohet përmes riteve fetare ose përmes një sërë formalitetesh ligjore, për të ruajtur një bashkësi të jetës dhe interesave.

⁴ Albana Metaj-Stojanova, *Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me Republikën e Shqipërisë*, Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, Tiranë, 2019

Gjithashtu, për martesën mund të themi se, është institucion shoqëror i cili gëzon njohje ligjore dhe, për rrjedhojë nënkupton për bashkëshortët një sërë detyrash dhe të drejtash të natyrës trashëgimore dhe familjare, të vendosura brenda legjislacioneve civile të secilit vend. Pra, kuptimi themelor i martesës është konstatimi i një familje, në mënyrë që t'u jap legjitimet fëmijëve të lindur ose të adoptuar gjatë bashkimit.

Ka përkufizime të ndryshme për martesat, si p.sh., martesa është bashkimi i lirë, solemn i jetesës së një burri dhe një gruaje, i mbështetur në barazinë morale dhe juridike, në ndjenjën e dashurisë, të respektit, të mirëkuptimit të ndërsjellë, që lidhet para organit kompetent me shprehjen e pëlqimit në mënyrë të lirë sipas procedurës së parashikuar me dispozita ligjore.⁵

E drejta e martesës është pjesë shumë e rëndësishme e së drejtës familjare. Kjo e drejtë rregullon dhe studion marrëdhëniet që krijohen me aktin e lidhjes së martesës dhe pasojat e pushimit të saj, si një nga bazat më të rëndësishme në krijimin e familjes.

Po ashtu, e drejta martesore është pjesë e së drejtës familjare, e cila rregullon dhe studion marrëdhëniet që lindin ndërmjet bashkëshortëve nga momenti i lidhjes së martesës, duke rregulluar kushtet, formën dhe procedurat për lidhjen e martesës.

Në rendin e të drejtave themelore të njeriut, një vend të veçantë zë edhe e drejta për martesë. Kjo e drejtë hyn në kategorinë e të drejtave sociale. Si të drejtat e tjera, edhe ajo disiplinohet nga ato parime të përgjithshme që qëndrojnë në themel të kësaj kategorie të drejtash.⁶ E drejta për jetë familjare dhe e drejta për martesë janë të njohura si të drejta themelore të njeriut që mbështeten në themelet e vetë ekzistencës dhe mbijetesës së shoqërisë sonë.⁷

Në këtë kohë mund të gjejmë shumë definicione të ndryshme për martesat në literaturë apo edhe në legjislacionet që rregullojnë çështjet martesore në shtete të ndryshme. Në këtë drejtim do ti paraqesim disa nocione të ndryshme për martesat.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë e definon në këtë mënyrë: *martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë*

⁵ Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2006, faqe 69.

⁶ Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006, faqe 67

⁷ Albana Metaj-Stojanova, *The fundamental human right to marry and to family life and their protection in the legal framework of the Republic of Macedonia*, in Iliria International Review, Vol. 7, no. 1, Prishtina, 2017

*mbrojtjen e veçante të shtetit.*⁸

Sipas Ligjit për familjen i Republikës së Kosovës: martesë është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.⁹

Edhe Ligji mbi Familjen i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jep definicionin juridik të martesës, sipas të cilit martesë është një bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve martesorë, të familjes dhe shoqërisë. Gjithashtu sipas këtij ligji, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve bazohen në vendimin e lirë të burrit dhe gruas për lidhjen e martesës, në barazinë e tyre, respektin reciprok dhe ndihmën reciproke.¹⁰

Pa dyshim që, lidhja e martesave në mes dy bashkëshortëve bëhet tek organi kompetent i gjendjes civile në komunën ku jeton (së paku njëri bashkëshort), duke u bazuar në ligjet e aplikueshme të atij shteti.

Martesa lidhet me pëlqim të lirë, përpara nëpunësit të gjendjes civile, mes një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Këto procedura iniciohen në zyrën e gjendjes civile të komunës përkatëse, ku bashkëshortët e ardhshëm kanë vendbanimin¹¹.

Për të realizuar një martesë të suksesshme, para organit kompetent, duhet që palët, apo burri dhe gruaje ti plotësojnë disa kriterë që janë të përcaktuara me ligjet e atij shteti, ku do të bëhet kurorëzimi.

Zyrtari i gjendjes civile që punon në Zyrën e Gjendjes Civile të komunës përkatëse, e që është i autorizuar që të bëjë lidhjen e martesës në mes dy personave, është i obliguar ta udhëheqë procedurën, por paraprakisht duhet të vërtetojë se bashkëshortët i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas akteve normative të atij shteti ku do të bëhet kurorëzimi tyre.

Gjithashtu, zyrtari i gjendjes civile, i autorizuar për ta udhëhequr një procedurë të plotë, për lidhjen e martesës në mes dy personave, nuk guxon në asnjë rrethanë të veprojë në kundërshtim me rregullat dhe standardet e kërkuara, të cilat duhet të jenë në përputhje të plotë me aktet normative

⁸ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes

⁹ Ligji nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës, neni 14

¹⁰ Ligji mbi Familjen, neni 6, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.153, prej 20.10.2014.

¹¹ <https://www.adisa.gov.al/martesa/>, 14.09.2023

të atij shteti, ku do të bëhet kurorëzimi i dy personave për lidhjen e martesës së tyre.

1.2 Kuptimi i institutit të martesës

Te nocioni i martesës kemi dhënë disa përkufizime nga autorë të ndryshëm të së drejtës familjare, dhe nga ligjet përkatëse të shteteve të ndryshme për lidhjen e martesës. Nga këto mund të nxjerrim përfundimin se instituti i martesës është me rëndësi të madhe në shoqëri për të krijuar stabilitet dhe siguri në marrëdhëniet e dy personave, por është shumë i rëndësishëm edhe për stabilitetin e familjes dhe gjithë shoqërisë.

Instituti martesor është një institucion që krijohet me lidhjen e dy personave në një marrëdhënie të ligjshme të martesës, e cila paraqet një angazhim të përbashkët për të ndërtuar një jetë me të drejta dhe detyrime në këtë marrëdhënie, duke e ndihmuar dhe mbështetur njëri tjetrin për të ndërtuar një marrëdhënie të shëndetshme.

Instituti i martesës është me rëndësi të madhe në shoqëri për të krijuar qëndrueshmëri dhe siguri në marrëdhëniet e dy personave, dhe më tej në marrëdhëniet familjare. Martesa vazhdon të jetë baza kryesore e krijimit të familjes.

Qëllimi kryesor i institutit të martesës është krijimi i familjes dhe zhvillimi i marrëdhënieve të shëndetshme, harmonike dhe të qëndrueshme midis bashkëshortëve, të bazuara tek besimi dhe respekti reciprok, por edhe zhvillimi i marrëdhënieve të shëndetshme midis prindërve dhe fëmijëve.

1.3 Zhvillimi historik i martesës

Duke qenë se martesa si institut i ka paraprirë shtetit dhe ligjit, në periudhat më të hershme të zhvillimit të njerëzimit lidhja e martesave nuk ka qenë e bazuar në ligj, por ato janë bërë në forma më primitive. Mirëpo, këto forma ndryshuan gradualisht me zhvillimin e së drejtës në përgjithësi, dhe të drejtës familjare e martesore në veçanti. Megjithatë, si forma më të vjetra të martesës në të drejtën romake, ishin grabitja dhe blerja e gruas.¹²

¹² Ivo Puhan, e Drejta Romake, Prishtinë, botimi i pestë, 1980. faqe, 183.

Këto dy forma të martesave një kohë të gjatë kanë qenë prezent edhe në Kosovë, dhe mund të përdoren ende në ndonjë lokalitet të vendit tonë. Gjithashtu, si formë mjaft e përdorur tek ne shqiptarët ka qenë edhe ajo e ndërrimit, në rastin kur dy familje shqiptare janë dakorduar që të shkëmbejnë vajzat ndërmjet njëra tjetrës. Njëra familje është dashur që t'ia jap vajzën familjes tjetër, për ta marrë pastaj vajzën e familjes tjetër.

Sipas disa hulumtimeve të fundit, martesate hershmejanë ende të pranishme, nëvëndin tonë. Traditat dhe zakonet tek komunitetet e ndryshme vazhdojnë të aplikohen në mënyrë të njëjtë, pa pësuar shumë ndryshime. Mirëpo, martesat e hershme konsiderohen shkelje të të drejtave të njeriut dhe dhunë në bazë gjinore.

Martesa e hershme përcaktohet si kurorëzim i dy personave, ku njëra ose të dy palët janë nën moshën 18 vjeçare.¹³

Në shumicën e rasteve, fenomenin e martesave të hershme më shpesh e hasim tek vajzat. Te këto martesa, shkaktarët e shpeshtë vlerësohen të jenë mendësia patriarkale, tradita, feja, presioni shoqëror për vajzat që të martohen sa më herët dhe varfëria. Për një familje të varfër, vajza e re është konsideruar si barrë ekonomike. E në raste të caktuara ka ndodhur që familja të marrë një vlerë të caktuar monetare nga martesa e fëmijës. E gjithë kjo është jo e drejtë dhe sjell pasoja të rënda në jetën e vajzave që martoheshin në moshë të re. Shpesh nga këto martesa kishte pasoja të cilat përfshinin dhunën në familje dhe izolimin nga shoqëria dhe familja, më pas divorci, shtatzënia e paplanifikuar, komplikimet gjatë shtatzënisë, ndërprerja e shkollimit dhe vështirësitë për qasje në punësim. Më vonë, në shumicën e vendeve, martesa e hershme janë ndaluar me ligj, sepse konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut. Martesat e hershme janë problem global. Sipas organizatës *Plan International*, 12 milion vajza në botë martohen para moshës 18 vjeçare – një në gati 2 sekonda. *Plan International*, po ashtu paralajmëron se nëse nuk punohet në këtë drejtim, më shumë se 150 milion vajza të mitura do të martohen para vitit 2030.¹⁴

1.3. 1 Lidhja e martesës në të drejtën romake

Martesa konsiderohet një ndër institucionet më të vjetra në zhvillimin e njerëzimit dhe të familjes, e cila ka kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit, dhe çdo herë ka shërbyer për rregullimin

¹³ <https://pikepamja.net/martesat-e-hershme-problem-shoqeror-ne-janjeve/>, 30.08.2023

¹⁴ Po aty

e marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve dhe për sigurimin e pasardhësve. Këtë funksion e ka pasur martesë edhe në të drejtën romake.

Në të drejtën bashkëkohore si zakonisht martesë përkufizohet si bashkësi jetësore e përhershme e rregulluar me ligj ndërmjet burrit dhe gruas. Edhe pse martesë edhe në të drejtën romake ishte bashkësi e përhershme jetësore e burrit dhe gruas, megjithatë ekziston dallim i madh ndërmjet martesës së atëhershme dhe të tanishme. Në martesën romake, e sidomos në format më të vjetra (martesë *cum manu*), as që mund të diskutohej për të drejtat dhe detyrimet reciproke ndërmjet bashkëshortëve, ngase element vendimtar në atë martesë ka qenë pushteti i burrit (*manus*).¹⁵ Por, edhe në fazat e më vonshme, kur u tejkaluan suazat e rregullimit të martesës sipas zakonit, dhe kur erdhën në shprehje në formë më të theksuar të drejtat konkrete të gruas, përsëri ndërmjet martesës në të drejtën romake dhe asaj bashkëkohore, kanë ekzistuar dallime të theksuara, sepse martesë në të drejtën romake nuk është konsideruar institucion juridik, por vetëm institucion social i cili ka pasur pasoja konkrete vetëm në familje dhe shoqëri.

Megjithatë, martesë në të drejtën romake patjetër duhet të lidhej në formën e paraparë me ligj, dhe për shtresat e ndryshme të popullatës praktikoheshin forma të ndryshme të lidhjes së martesës. Në kohët e lashta, forma më e vjetër e krijimit të lidhjes së martesës, nga burimet e asaj kohe, përmendet grabitja - *raptus melierium* (legjenda për sabinianët).¹⁶

Ndërkaq, forma më e vjetër e lidhjes së martesës me marrëveshje në të drejtën romake ishte *coemptia*, ose blerja fiktive e gruas në formën për *aes et libram*. *Coeemptio* (nga *cum* = me dhe *emere* = blerë) ishte blerja e gruas sipas formës *mancipatio*.¹⁷

Supozohet se gjatë periudhës së kohës primitive të romakët dhe popujt e tjerë në një shkallë të caktuar të zhvillimit, me blerje siguroheshin gra për nevoja familjare, si për lindjen e fëmijës, por edhe për punë. Mirëpo, gjatë zhvillimit historik të romakëve, nuk ka të dhëna për blerjen efektive të gruas, sepse kjo ishte simbolike.

Supozohet se kjo formë u shfaq në kohën kur gruaja me të vërtetë blihej, *pater familjas* i gruas në prezencë të pesë dëshmitarëve dhe *libripen-sit*, ia dorëzonte nusen *pater familias-sit* të burrit, ose vetë burrit personalisht nëse ai ishte person *sui iuris*, kurse burri personalisht ose *pater familjas* i tij

¹⁵ Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, e Drejta Romake, Prishtinë 2015, faqe 170

¹⁶ Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, e Drejta Romake, Prishtinë 2015, faqe 176

¹⁷ Po aty.

e shqiptonte (citonte) formulën e përvetësimit dhe ia paguante çmimin e kontraktuar *pater familjas*-it të familjes së gruas.¹⁸

Ndërsa, forma e dytë për krijimin e lidhjes së martesës, e paraparë me ligji ishte *confarreatio*, forma më solemne që e praktikonin patricët e që shoqërohej me rite fetare.

Gjatë lidhjes së kësaj martese duhet patjetër të ishin prezent të fejuarit (nusja dhe dhëndrri), *pater familjas*-it e tyre, *pontifex maximus*, *flamen Dialis* dhe së paku 10 qytetarë romak madhorë.¹⁹

Një prej formave më të shpeshta dhe më të thjeshta të lidhjes së martesës romake ishte *usus*. Kjo formë ishte jetesa e përbashkët e bashkëshortëve. Për nga forma dhe manifestimet e jashtme, *usus* ishte i lidhur në disa zakone, prej të cilëve më i rëndësishmi ishte sjellja e të fejuarës në shtëpinë e të fejuarit-in *domun deduction*.²⁰

Nga kjo mund të konstatojmë se forma më e thjeshtë dhe e shpeshtë joformale për lidhje të martesës ka qenë *usus* - themelimi i jetesës së përbashkët. Kjo formë e lidhjes së martesës u shfaq në qarqet e varfra të plebenjve, dhe ndiqte transferimin e thjeshtë të bashkëshortes në shtëpinë e bashkëshortit.

1.3.2 Lidhja e martesës në të drejtën zakonore shqiptare

E drejta zakonore shqiptare është një e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga tradita gojore që ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në vendin tonë.²¹ Ajo nuk është krijuar nga ndonjë person i vetëm apo nga ndonjë organ i vetëm legjislativ. Të gjitha këngët, vallet, mitet, kultura materiale etj., janë krijuar nga populli gjatë shekujve, i cili ka derdhur në të filozofinë, mendësinë dhe mençurinë e tij. E drejta zakonore shqiptare është një monument juridik madhështor dhe pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore shqiptare. Martesa sipas të drejtës zakonore përbënte zbatimin e përfunduar ndërmjet familjes së djalit e të vajzës në fazën e fejesës.²² Edhe në atë kohë, martesa ishte një institut më vete, sepse krijonte një gjendje të re faktike dhe juridike për palët. Kanunet kanë përmbajtur mjaft norma juridike që i kanë rregulluar marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet familjes së djalit dhe vajzës.

¹⁸ Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, e Drejta Romake, Prishtinë 2015, faqe 177

¹⁹ Po aty

²⁰ Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, e Drejta Romake, Prishtinë 2015, faqe 177

²¹ Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Tiranë, 2001, faqe 229

²² Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Tiranë, 2001, faqe 247

Në përmbledhjen e Kanunit të Lek Dukagjinit të Sh. K. Gjecovit jepet ky përkufizim i martesës: *“M’u martue më kanun do me thanë m’u ba shpi, me i a shtu shpis një rob ma tepër, sa për krah të punve, sa për të shtume të fmive”*.²³ Prej këtij përcaktimi del qartë funksioni shoqëror i martesës si një bazë për krijimin e familjes, funksioni ekonomik për shtimin e krahëve të punës, dhe për zhvillimin e brezave të ardhshëm.

Në Kanunin e Lek Dukagjinit dallohen katër mënyra të kryerjes së martesës:²⁴

a) Martesa me kurorë, e pëlqyer nga feja dhe Kanuni.

Këtu bëhet fjalë për martesën monogame, të kryer me shkuesi që përforcohej më vonë me vënien e kurorës të krishterët e ritit katolik dhe ordodoks. Ndërsa, te popullsia myslimane kjo rregullë nuk vlente, sepse legalizimi i martesës bëhej me sheriat.

b) Martesa mbi kurorë.

Kjo martesë krijohej kur burri, krahas bashkëshortes së ligjshme, merrte një grua të dytë, mbi kurorë. Sipas Sh.K.Gjecovit, kjo lidhje e martesës ishte *“kundra fesë dhe Kanunit të Lekës”*. Në fakt ishte kundër fesë së krishterë, të ritit katolik dhe ortodoks, por nuk ishte në kundërshtim me të drejtën zakonore. Poligamia, si mënyrë e lidhjes së martesës, ishte në thelb një mbeturinë e kohëve të vjetra, që konsiderohet një formë më e ulët e martesës në krahasim me atë monogame. Ndërsa, kjo formë, në të drejtën zakonore lejohet vetëm si përjashtim për të pasur fëmijë, sidomos djem, dhe kur gruaja e parë nuk kishte mundësi të lindte. Poligamia, gjithashtu krijohet me gruan e vëllait të vdekur (levirate).

c) Martesa me grabitje.

Ishte një nga format më të lashta që ka ekzistuar ndër popuj të botës për të krijuar lidhje martesore. Në të drejtën zakonore shqiptare, kjo formë e lidhjes së martesës njihej si mënyra e kundërligjshme *“kundra kanujet”* dhe nuk ishte shumë e përhapur.

d) Martesa me provë.

Ishte një martesë fakti. Palët, familja e djalit dhe vajzës, pajtoheshin që vajza ose gruaja e shkurorezuar të shkonte në shtëpinë e djalit e të bashkëjetonin si bashkëshortë, por pa lidhur

²³ Po aty

²⁴ Aleks Luarasi, Historia e Shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Tiranë ,2001, faqe 247-249

martesë. Kjo kushtëzohej nga fakti nëse gruaja do lindte ose jo fëmije brenda një periudhe të caktuar, që zakonisht ishte një vit. Brenda kësaj kohe, nëse vërtetohej fakti juridik, lindja e fëmijës, palët bënë kurorëzim dhe martesë me provë i krijonte efektet juridike që nga çasti i lidhjes së martesës. Në këto raste, fëmijët konsideroheshin si të lindur nga një martesë legjitime.

1.3.3 Lidhja e martesave në kohën bashkëkohore

Procesi i evolucionit të familjes dhe martesës ka kaluar nëpër etapa të zhvillimit që nga koha romake, e deri te koha e sotme bashkëkohore. Ky proces është zhvilluar nëpër periudha të ndryshme kohore dhe në periudha të caktuara është atakuar nga zakonet e ndryshme të krahinave apo vendeve të ndryshme, por shpesh është sfiduar edhe nga legjislacioni i shteteve të ndryshme, ku në disa raste ka qenë i ndryshëm prej vendi në vend.

Edhe në Kosovë, institucioni i familjes dhe i martesës, në varësi edhe nga zhvillimi ekonomik-shoqëror, ka kaluar historikisht nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Faktor i rëndësishëm ka qenë faktori tradicional. Pa dyshim, se ndikim të padiskutueshëm ka lënë tradita dhe zakonet, qoftë të pashkruara apo edhe të shkruara dhe të përmbledhura, siç mund të jenë rregullat e përmbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit apo variantet e tjera të tij. Sidoqoftë, rregullat e të drejtës familjare dhe ato të martesës fillojnë të marrin trajtën e rregullimit institucional pas Luftës së Dytë Botërore, kur për herë të parë (përfshirë një periudhë e shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës, edhe në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës gjeti zbatim Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929), familja dhe martesë rregullohen me ligj, përkatësisht me Ligjin Themelor për Martesën, të datës 13 prill 1946, i cili gjeti zbatim në tërë territorin e ish-RFPJ-së.²⁵

Ndërkohë që, me kalimin e kohës dhe evoluimin e shoqërisë ka evoluuar edhe instituti i familjes dhe i martesës. Gjithashtu, edhe Kosova, ka përparuar në aspektin procedural dhe në nxjerrjen e akteve normative për rregullimin e institucionit të familjes dhe martesës. Në këtë drejtim, në shoqërinë bashkëkohore vjen deri tek ndryshimi drastik i thelbit të domethënies dhe kuptimit për martesën në të gjitha vendet e përfundimtare, por edhe në vendin tonë.

Në kohën bashkëkohore martesë lidhet nga dashuria e jo për interes. Martesat bashkëkohore janë lidhje të vullnetshme midis një burri dhe një gruaje, të bazuara në ndjenjat reciproke të dashurisë, besimit, respektit, mirëkuptimit, etj. Martesat bashkëkohore janë lidhje të qëndrueshme, stabile

²⁵ Idrizi, N. (2018) "Pasojat juridike të shkurorëzimit vështrim krahasues Kosovë-Shqipëri, Prishtinë, fq.9,

dhe monogame midis partnerëve martesorë. Në kohën e tashme, martesë konsiderohet model ideal për rregullimin e marrëdhënieve midis gjinive të kundërta.

Kohëve të fundit, aspekte të caktuara të marrëdhënieve martesore, si p.sh. rregullimi i marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve, etj., në disa shtete bëhet edhe me anë të kontratave martesore apo paramartesore.

1.4 Natyra juridike e institutit të martesës

Nga shkenca e të drejtës familjare, një nga çështjet më të diskutueshme teorike është padyshim përkufizimi i nocionit të martesës. Në këtë drejtim, si rezultat i pikëpamjeve të ndryshme mbi natyrën juridike të martesës, qëllimit dhe përmbajtjes së saj, periudhës kohore dhe gjendjes në shoqëri, kemi përkufizime të shumta të nocionit të martesës. Ligjet e aplikueshme për familjen, për dallim nga shkenca juridike, shpesh definicionin e nocionit ‘martesë’ e shmangin. Si pasojë e kësaj, rrallë herë në legjislacionet familjare bashkëkohore kemi shembuj të përkufizimit ligjor të nocionit të martesës, duke përfshirë edhe të drejtën tonë familjare. Sipas ligjit për familje, *“Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”*.²⁶ Nisur nga ky definicion ligjor rrjedhin disa karakteristika të rëndësishme për nocionin ligjor të martesave. Nga ky përkufizim, martesë paraqet një bashkësi jetësore të rregulluar me ligj, duke shprehur interesin shoqëror për martesën, si kategori shoqërore juridike. Pastaj, martesë mund të lidhet vetëm në mes një burri dhe gruaje, pra ndërmjet personave me gjini të ndryshme. Sipas ligjit për familje, qëllimi kryesor i martesës është krijimi i bashkësisë së jetës ndërmjet një burri dhe një gruaje, me çka plotësohen nevojat e tyre emocionale, seksuale, psikologjike dhe të tjera. Dhe, gjithashtu në martesë realizohen interesat e përbashkëta të bashkëshortëve martesorë, të familjes dhe shoqërisë.

Prej kësaj mund të nxjerrim përfundimin se martesë nuk është vetëm institucion juridik, me të cilin realizohet interesi privat, por është edhe institucion shoqëror nga i cili ka interes edhe shoqëria.

Në shkencën juridike, sa i përket nocionit të martesës, ka mos pajtime edhe sa i përket natyrës juridike të martesës. Për shkak të marrëdhënieve të ndërlikuara që krijohen në martesë, kemi teori

²⁶ Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës, neni 14

të shumta ku me anë të cilave shpjegohet natyra juridike e martesës. Megjithatë, sipas rëndësisë dhe përhapjes së tyre dallon dy teori kryesore, dhe këto janë:²⁷

- Teoria kontraktore, dhe
- Teoria institucionale mbi martesën.

1.5 Parimet e të drejtës martesore

Kushtetuta, si akti më i lartë ligjor juridik i një vendi, i ka edhe parimet themelore të së drejtës martesore. Këto parime, pastaj vendosen në themelet e shkencës martesore juridike. Ato përpunohen dhe garantohen, si në ligjin për familje, por edhe me dispozita të tjera përkatëse ligjore. Prandaj, respektimi i parimeve të së drejtës martesore është i domosdoshëm mes bashkëshortëve.

Mos respektimi i dispozitave ligjore të natyrës urdhëruese, me rastin e lidhjes së martesës shkakton pavlefshmërinë e martesës.

Parimet e të drejtës martesore, mund të gjenden të trajtuara prej shumë autorëve, mirëpo parimet themelore të së drejtës martesore janë: ²⁸

- a) Parimi i barazisë,
- b) Parimi i laicitetit,
- c) Parimi i institucionit,
- d) Parimi i monogamisë,
- e) Parimi i vazhdimësisë së jetesës martesore.

Parimi i barazisë

Në shekuj pozita e gruas ka qenë e nënshtruar dhe e pabarabartë me burrin. Burri kishte pushtetin e plotë mbi gruan dhe mbi pasurinë e saj, ndërsa gruaja ndodhej në pozitë inferiore dhe diskriminuese. Kjo vlente për të gjitha shoqëritë e lashta të njerëzimit, siç ishte ajo indiane, latine dhe romake. Edhe në kodifikimet borgjeze të shekullit XIX, vazhdon të ruhet mbizotërimi i burrit dhe nënshtrimi i gruas në marrëdhëniet familjare dhe martesore. Gjendja ndryshon vetëm në

²⁷ Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Mickoviq, Angel Ristov, E Drejta Familjare, Tetovë 2020

²⁸ Hamdi Podvorica, Prishtine 2006, faqe 61-65

gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, kur legjislacionet e të gjitha vendeve të zhvilluara evropiane inkorporojnë parimin e barazisë midis burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës, dhe në marrëdhëniet familjare dhe martesore.

Parimi i laicitetit

Në rregullativën ligjore gjen shprehje shumë shpesh definicioni se martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj. Nga përmbajtja e një formulimi të tillë rrjedh interesimi i shoqërisë së gjerë që ky institucion shoqëror të jetë i rregulluar me dispozita ligjore dhe i mbrojtur nga shoqëria dhe shteti. Në ndryshim nga e kaluara ku marrëdhëniet martesore dhe familjare kanë qenë të rregulluara nga religjioni dhe tradita.

Parimi i institucionit

Martesa është institucion shoqëror dhe gëzon mbrojtje shoqërore. Martesa dhe marrëdhëniet martesore juridike janë të rregulluara me dispozita ligjore. Martesa tek në është një institucion laik. Mbrojtje juridike gjen vetëm martesa civile, e cila është e rregulluar juridikisht dhe lidhet përpara organit kompetent shtetëror.

Parimi i monogamisë

Ky është padyshim një nga parimet themelore të së drejtës martesore. Me monogami kuptojmë martesën në të njëjtën kohë të një burri me një grua. Parimi i monogamisë gjen shprehje në dispozitën e nenit 14 të Ligjit për Familjen i Kosovës, por edhe në dispozitat ligjore të vendeve të tjera, me të cilat rregullohet martesa dhe marrëdhëniet martesore. Martesa monogame është trajtë dominuese e martesës në të drejtën bashkëkohore. Bigamia, lidhja e një martese të dytë përderisa vazhdon të ekzistojë një martesë paraprake, jo vetëm që është pengesë për lidhjen e martesës, por përbën edhe vepër penale të ndëshkueshme me heqje lirie.

Parimi i vazhdimësisë së jetesës martesore

Martesa është po ashtu bashkësi e vazhdueshme

e jetesës së burrit me gruan. Kjo do të thotë se në pikëpamje kohore martesë nuk mund të kufizohet, veçse zgjat aq sa zgjat edhe jeta e bashkëshortëve.

Kapitulli II

2. KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESËS DHE PROCEDURA PËR LIDHJEN E MARTESËS

2.1 Kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj

Për lidhjen e martesës, kushtet mjaft të ashpra kanë qenë në kohën kur vlente vetëm forma fetare e lidhjes së martesës, nga trysnia e kërkesave të ndryshme fetare, klasore dhe familjare. Mirëpo, pas reformave të reja të së drejtës familjare, kushtet për lidhje të martesave ndryshuan në mënyrë të ndjeshme. Këto kushte, po bëhen gjithnjë e më të favorshme për lidhjen e martesës.

Duke u përmënuar kushtet për lidhjen e martesës, individit ka lirinë e lidhjes së martesës, e cila, sipas rregullës, përfshin mundësinë e lidhjes së martesës ose të mos lidhjes së saj, që bashkëshortët të zgjedhin lirisht njëri-tjetrin.²⁹

Në këtë drejtim, një kthesë e rëndësishme është bërë me Deklaratën Universale mbi të drejtat e njeriut në vitin 1948, ku në dispozitën e nenit 16 është paraparë – burri dhe gruaja të moshës madhore pa kurrfarë kufizimi racor, kombëtar, fetar kanë të drejtë të lidhin martesë e të formojnë familje; janë të barabartë me rastin e lidhjes së martesës, gjatë ekzistimit dhe me rastin e zgjidhjes së saj.³⁰ Pra, martesat mund të lidhen vetëm në mënyrë të lirë, me pëlqim të plotë të personave që dëshirojnë të lidhin martesë, ndërsa familja është celulë natyrore dhe themelore e shoqërisë, që ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës sipas legjislacioneve familjare janë:³¹

- Mosha 18 vjeç,
- Pëlqimi i lirë për martesë përpara nëpunësit të gjendjes civile, dhe
- Mos ekzistenca e ndalimeve (pengesave) ligjore.

Edhe ligji i aplikueshëm i Kosovës parasheh kushtet për lidhjen e martesës, të cilat janë:³²

(1) Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.

(2) Për shkaqe të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta

²⁹ Hamdi Podvorica, e Drejta e Familjare, Prishtinë, 2011, faqe 71

³⁰ Neni 16 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948

³¹ Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006, faqe 94

³² Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, neni 16

martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.

(3) Para se të marrë vendimin, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë, do ta dëgjojë të miturin dhe prindërit përkatësisht kujdestarin e tij. Gjykata gjithashtu do të dëgjojë personin me të cilin i mituri ka për qëllim të lidhë martesë, mendimin e institucionit përkatës shëndetësor dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme për vendimin.

Përveç ligjeve të shteteve të ndryshme, kushtet e martesës i kanë paraparë edhe shumë autorë.

Një parashikim për kushtet e lidhjes së martesës mund të ndahen në këtë mënyrë:³³

- 1) Kushtet materiale (themelore), dhe
- 2) Kushtet formale (procedurale)

Ndërkaq, si kushte materiale konsiderohen kushtet themelore:³⁴

- Mosha madhore
- Dallimi i sekseve
- Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm
- Forma e lidhjes së martesës

Mirëpo, për vlefshmërinë e martesës nuk duhet të këtë:

- Pengesa martesore, dhe
- Ndalesa martesore.

Forma për lidhjen e martesës është civile. Për herë të parë, kjo formë civile e detyrueshme për lidhje të martesës është paraparë në Shqipëri, me Kodin Civil të vitit 1929. Sipas nenit 149 po të këtij kodi, martesa celebrhet botërisht përpara nëpunësit të gjendjes civile të komunës ose të bashkisë.³⁵

Kjo formë për lidhje të martesës nënkupton mënyrën dhe procedurën për lidhje të martesës, që martesa të jetë e vlefshme. Edhe historikisht nëse e shikojmë, procedura për lidhje të martesës ka qenë formale për shkak të rëndësisë që ka martesa si bazë për themelimin e familjes. Ndërkaq, më vonë ka ardhur deri te thjeshtimi i procedurës drejt një procedure joformale.

2.1.1 Lidhja e martesës nga bashkëshortët me sekse të kundërta

Për lidhjen e martesës, sekset e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Nëse shikojmë në retrospektivë, martesa ka qenë një privilegj i gruas dhe burrit,

³³ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 91

³⁴ Po aty.

³⁵ Hamdi Podvorica, e Drejta e Familjare, Prishtinë, 2011, faqe 91

i dy personave me sekse të kundërta apo me gjini të kundërta. Qëllimi natyror i martesës ka qenë, është dhe mbetet lindja, përkujdesja e mirë dhe rritja e fëmijëve dhe marrëdhënia në mes bashkëshortëve. Nga kjo mund të konstatojmë se vetë instituti i martesës mbi të gjitha nënkupton lidhje të personave me sekse të kundërta, martesë lidhet mes burrit dhe gruas, dhe kjo është e rregulluar edhe me dispozita ligjore në vendin tonë, ku parashihet qartë se për lidhjen e një martese nevojiten dy persona me sekse të kundërta.³⁶ Nga kjo del se në rregullativën ligjore juridike të Kosovës, nuk lejohet martesë e dy personave me sekse të njëjta. Mungesa e sekseve të kundërta paraqet pengesë absolute për lidhjen e një martese. Kjo, sepse martesë është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas dhe, si e tillë, është përkufizuar në shumë dispozita të Ligjit për Familje të Kosovës, por edhe të Kodit të Familjes së Shqipërisë dhe Ligjit për familje të Maqedonisë.³⁷

Kur jemi te kjo çështje duhet theksuar se në nenin 37 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garantohet e drejta e martesës dhe e familjes së çdo personi, ku në paragrafin 1 të këtij neni thuhet *"në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin"*. Ndërsa, në paragrafin 2 thuhet *"martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve"*. Nga kjo, mund të kuptojmë se Kushtetuta nuk e sanksionon lidhjen e martesës në mes të personave me sekse të njëjta. Mirëpo, është Ligji për Familje i Kosovës, ku në dispozitën e nenit 28, e ka paraparë qartë se lidhja e martesës në vendin tonë, mund të bëhet vetëm mes personave me gjini të kundërta.

2.1.2 Pajtimi i vullneteve të bashkëshortëve për lidhjen e martesës

Kushti themelor për lidhjen e martesës së vlefshme është që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë pëlqimin se martesë e lidhur është bërë me vullnetin e lirë, dhe se nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa martesore.

Gjithashtu, kjo çështje është e definuar edhe në dispozitat ligjore të shtetit tonë, ku thuhet se martesë nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo përmes ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.³⁸

³⁶ Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, neni 28

³⁷ Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2011, faqe 73

³⁸ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 18

Bashkëshortët këtë deklaramund ta bëjnë me shkrim apo me gojë. Deklarimi me gojë gjithsesi duhet të shënohet në procesverbal.

Deklarimi i pëlqimit bëhet në të njëjtën kohë dhe ka rëndësi në aspektin e sigurisë juridike, nga shkaku se diferenca eventuale kohore mundëson hapësirë për tërheqjen e pëlqimit të dhënë kohë më parë, nga njëri bashkëshort.³⁹

Është shumë e rëndësishme që deklarimi të bëhet në mënyrën e parashikuar në ligj, pa kushtëzime.

Para së gjithash, vullneti i shprehur për të qenë një martesë e vlefshme duhet të ketë cilësitë e caktuara:⁴⁰

- a) të jetë real e jo simulativ,
- b) të jetë serioz e jo i shprehur sa për shaka, dhe
- c) dy deklaratat duhet të jepen në të njëjtën kohë, suksesivisht në çastin e lidhjes së martesës.

Në këto raste, secili bashkëshort duhet ta shpreh personalisht vullnetin e vet dhe veç e veç, dhe kjo nënkupton prezencën e të dy bashkëshortëve. Shumë rrallë mund të ndodh në praktikë që shprehja para organit kompetent të mos jetë reale. Ndërkaq, mungesa e vullnetit të vërtetë paraqet të metën kryesore në vullnetin e deklaruar për lidhjen e martesës.

2.1.3 Forma për lidhjen e martesës

Një ndër kushtet themelore për lidhjen e martesës është edhe lidhja e martesës në formë të paraparë me ligj. Edhe sikur të ishin plotësuar të gjitha kushtet e tjera themelore (mosha madhore, dallimi i sekseve, deklarimi i vullnetit të lirë), po nuk lidhet martesa në mënyrën që është përcaktuar me ligji, nuk ka martesë dhe të gjitha kushtet themelore mbesin pa efekt juridik.

Natyrisht që martesa duhet të lidhet para organit kompetent, përkatësisht para ofiqarit të gjendjes civile në formën e paraparë me ligj. Forma për lidhjen e martesës është e përcaktuar me dispozita ligjore në shtetin tonë, ku legjislacioni pozitiv e ka paraparë kompetencën e organit për lidhjen e martesës dhe mënyrën e lidhjes së saj. Sipas nenit 28 të Ligjit për Familje të Kosovës,

³⁹ Hamdi Podvorica, Prishtinë 2011, faqe 73.

⁴⁰ Po aty.

për lidhjen e martesës është e nevojshme që dy persona që dëshirojnë të lidhin martesë në prani të tjerëve të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë para ofiqarit.⁴¹ Gjatë procedurës për lidhjen e martesës duhet të plotësohen edhe disa kushte tjera siç janë: prania e dy bashkëshortëve, dëshmitarëve, nëpunësit të gjendjes civile, pastaj mënyra e dhënies së deklaratave dhe regjistrimi i martesës. Pa plotësimin e këtyre kushteve nuk mund të lidhet martesë. Dhe, nëse nuk janë plotësuar këto kushte, martesë mund të jetë objekt anulimi, sepse si e tillë është e pavlefshme.

Ndërkaq, objektivi kryesor nuk është thjeshti “të impresionojë” palët mbi rëndësinë e lidhjes së martesës (ndonëse në fakt e ka edhe këtë mision reflektimi), por, gjithashtu, të sigurojë dëshmi për (pa)vlefshmërinë e saj, të realizojë një regjistrim zyrtar apo dokumentim me shkrim për efekt të provës, duke e bërë martesën një ngjarje, sa personale, vetjake, aq edhe tipike (tipike në kuptimin e rregullave ose të procedurave që duhet të respektohen nga çiftet të ndryshme, por sipas të njëjtit format)⁴². Akti i lidhjes së martesës detyrimisht duhet të realizohet përmes një procedure formale të paraparë me ligj. Pra, kjo lidhje është një veprim solem (ad *solemnitatem*).

Forma e lidhjes së martesës tregon edhe një herë se e drejta jonë hyn në kuadrin e të drejtës formale në çështje që lidhen me familjen dhe martesën.

Këtë karakteristikë e kanë trashëguar nga e drejta romake të gjitha legjislacionet që i përkasin sistemit të mbyllur të së drejtës ose, siç themi ndryshe, sistemit kodifikues.⁴³

2.1.4 Mosha madhore e bashkëshortëve

Në kohën bashkëkohore, mosha madhore e bashkëshortëve është kushti bazë dhe themelor për lidhjen e martesës. Kjo tani është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për Familje të Kosovës, edhe pse në kohën e më hershme, lidhja e martesave është bërë edhe nën moshën 18 vjeçare.

Mirëpo, kjo çështje tani është e rregulluar me aktet normative, dhe kushti themelor për lidhje të martesës është mosha madhore, e njëjtë për të dy personat që do të kurorëzohen.

Sa i përket kësaj çështje, legjislacioni shqiptar bën një hap cilësor përpara lidhur me barazinë gjinore. Ndryshe nga Kodi i Familjes i vitit 1982, ku ekzistonte diferenca në moshë midis burrit dhe gruas (16 për gratë dhe 18 për burrat), Kodi aktual i Familjes i vitit 2003, realizon në këtë

⁴¹ Hamdi Podvorica, Prishtinë 2011, faqe 96

⁴² Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006, faqe 119.

⁴³ Po aty.

mënyrë mundësitë ligjore të barabarta për martesë nga pikëpamja madhore, edhe për burrat, edhe për gratë. Kjo moshë, 18 vjeç, që është edhe mosha madhore, konsiderohet si “dysHEMEJA” e tolerueshme për lidhjen e martesës.⁴⁴

Më këtë mund të themi se martesë është një akt shumë i rëndësishëm për jetën e njeriut dhe detyrimisht kërkon pjekuri fizike dhe psikike të mjaftueshme që të marrë përsipër detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë bashkëshortore, jo vetëm emocionalisht, por, në thelb, realisht.

Kjo lidhet edhe me parashikimet që ka bërë Kodi Civil shqiptar lidhur me zotësinë e plotë për të vepruar, e cila zotësi arrihet në moshën 18 vjeç, moshë e cila sipas legjislacioneve quhet moshë madhore dhe personi në këtë moshë fiton zotësinë e plotë për të vepruar. Pazotësia për të lidhur një martesë në një moshë të caktuar ka qenë një çështje shumë e diskutueshme në kohë të ndryshme dhe në sisteme juridike të ndryshme dhe, nëse shohim realitetin shqiptar dhe rregullat e së drejtës që kanë vepruar, e kuptojmë më mirë këtë.⁴⁵

2.2 Pengesat martesore

Për të lidhur një martesë duhet të mos ketë pengesa ligjore për lidhjen e saj. Shumë autorë përmes punimeve të tyre në të drejtën familjare, kanë paraqitur opinionet e tyre për pengesat martesore. Mirëpo, janë ligjet e shteteve përkatëse që, përmes dispozitave ligjore i kanë paraqitur pengesat martesore për lidhje të martesës.

Ndërkaq, pengesat martesore janë fakte dhe rrethana ekzistuese që mund ta pengojnë që të bëhet një martesë e vlefshme, ndërsa lidhja e martesës duke pasur pengesa të tilla, si pasojë ka anulimin e tyre. Sipas literaturës, pengesat martesore quhen kushte negative për lidhjen e martesës.

Efekti juridik i tyre është *erga omnes*, çka do të thotë se efekti i tyre është ndaj çdo personi të i cili ekzistojnë këto pengesa.⁴⁶

Ka situata kur me plotësimin e kushteve themelore të lidhen martesë, por, nëse gjatë procedurës paraqiten pengesa martesore, atëherë ato janë shkak për ta anuluar martesën.

Në shumicën e rasteve është deklaruar vullneti i lirë i bashkëshortëve për lidhjen e martesës dhe ajo martesë realizohet. Mirëpo, kur vullneti është deklaruar me forcë, mashtrim, lajthim, në këto

⁴⁴ Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006, faqe 94-95

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Abdulla Aliu, e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 97

raste kërkohet anulimi i lidhjes së martesës, sepse ekziston mungesa e vullnetit të lirë, si kusht themelor për lidhje të martesës, e që është njëra nga pengesat martesore.

Gjatë lidhjes së martesës, pengesat dallojnë prej kushteve themelore, sepse pa plotësimin e kushteve themelore, ofiqari nuk i vazhdon procedurat dhe nuk mund të bëhet lidhja e martesës. Mirëpo, ka raste që të lidhet martesa me pengesa martesore, por martesat e tilla janë të pa vlefshme dhe mund të anulohen.

Zyrtari i Gjendjes Civile, duhet të ketë kujdes që mos të lejojë pengesa martesore as në momentin e lidhjes së martesës, por nëse nuk janë konstatuar në momentin e lidhjes, martesa mund të lidhet. Mirëpo, konstatimi i më vonshëm i pengesave martesore, shpie në anulimin e martesës. Në të gjitha vendet e botës këto çështje janë të rregulluara me dispozita ligjore të atij vendi.

Edhe shteti ynë e ka të rregulluar lidhjen e martesës pa pengesa martesore, sepse sipas legjislacionit janë të përcaktuara në mënyrë taksative (*numerus clausus*) pengesat martesore, të cilat janë:⁴⁷

- mungesa e vullnetit,
- martesa ekzistuese,
- mungesa e zotësisë për të vepruar,
- gjinia (e gjakut, krushqisë, adoptimit),
- mituria.

2.2.1 Martesa ekzistuese (bigamia)

Martesa ekzistuese është njëra nga pengesat martesore për lidhjen e martesës së dy bashkëshortëve. Me këtë pengesë, ligji shprehimisht e ka paraparë pavlefshmërinë e martesës së re deri sa martesa e mëparshme e njërit nga bashkëshortët nuk zgjidhet ose nuk pushon në mënyrën e parashikuar me ligj. Pra, nuk mund të lidhet një martesë tjetër deri sa të zgjidhet e mëparshmja. Kështu parashihet që martesa e lidhur në kohën e ekzistimit të një martese të mëparshme të njërit bashkëshort është nule.⁴⁸ Një rregull e tillë është shprehur edhe në parimin e monogamisë, i cili gjen zbatim edhe te ne, si një themel i rëndësishëm i së drejtës martesore dhe i civilizimit juridik.⁴⁹ Martesa e dytë e lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore, nuk mund t'i heqë fuqinë ligjore martesës së parë.

⁴⁷ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, nenet 18-24

⁴⁸ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 62

⁴⁹ Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2011, faqe 81

Ka raste kur martesë e re nuk shpallet e pavlefshme, nëse martesë ekzistuese zgjidhet ndërkohë nga gjykata, para se të mbarojë gjykimi mbi martesën e re. Sepse, gjykata fillimisht shqyrton çështjen e martesës së mëparshme dhe nëse kjo shpallet e pavlefshme, atëherë martesë e dytë shpallet e vlefshme.

Zyrtari i Gjendjes Civile, është i obliguar të vërtetojë nëse bashkëshortët e ardhshëm janë të lidhur me një martesë tjetër. Këtë e vërteton me anë të certifikatës së lindjes, e cila nuk mund të jetë më e vjetër se gjashtë muaj. Kjo nuk do të thotë se personi që ka qenë një herë i martuar nuk mund të martohet përsëri, sepse një person mund të jetë disa herë i martuar, por mund të lidhë martesë të re vetëm atëherë kur e ka zgjedhur të mëparshmen në mënyrë të parashikuar me ligj. Bigamia përbën edhe vepër penale që dënohet me burgim sipas legjislacionit penal të vendit.

2.2.2 Moshë e mitur dhe instituti i emancipimit

Moshë e mitur është njëra prej pengesave martesore që pengon lidhjen e martesave në kohën bashkëkohore mes personave të cilët nuk e kanë arrit pjekurin martesore. Në të drejtën familjare pjekuria martesore arrihet me moshën madhore⁵⁰.

Edhe sipas dispozitave ligjore në të drejtën familjare të shtetit tonë, moshë e mitur është pengesa kryesore për lidhjen e martesës. Kjo është e përcaktuar në kushtet për lidhjen e martesës, ku thuhet që; personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.⁵¹

Ndalesë e martesave të mitura ka një arsyetim shoqëror dhe për këtë kjo ndalesë parashikohet në të gjitha legjislacionet familjare evropiane.⁵²

Por, nuk janë krejtësisht të ndaluara martesat e tilla për moshën e mitur, sepse ka disa procedura shtesë për të arritur të lidhja e martesës në këtë moshë. Kjo mund të arrihet përmes organit kompetent, përkatësisht nga gjykata përkatëse.

Në këtë drejtim, për shkak të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta

⁵⁰ Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakui, Dejan Micković, Angel Ristov, e Drejta Familjare, Tetovë 2020, faqe 130

⁵¹ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 16 paragrafi 1.

⁵² Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakui, Dejan Micković, Angel Ristov, e Drejta Familjare, Tetovë 2020, faqe 131

martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore. Para se të marrë vendimin, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë, do ta dëgjojë të miturin dhe prindërit përkatësisht kujdestarin e tij. Gjykata gjithashtu do të dëgjojë personin me të cilin i mituri ka për qëllim të lidhë martesë, mendimin e institucionit përkatës shëndetësor dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme për vendimin. Dhe ne bazë të këtyre rrethanave mund të nxjerr aktvendim për lejimin e lidhjes së martesës për të miturit.⁵³ Në aktvendimin me të cilin të miturit i lejohet lidhja e martesës, deklarohet personi me të cilin lejohet të lidhë martesë dhe se martesa mund të lidhet vetëm pas plotfuqishmërisë së vendimit. Megjithëse vendimi ka karakter konstitutiv sepse shërben si bazë për lidhjen e martesës, i mituri do të fitojë zotësinë e plotë për të vepruar vetëm nëse martesa lidhet dhe vetëm nëse lidhet me personin e deklaruar në aktvendim. Kur vërtetohet se një person ka arritur pjekurinë trupore dhe mendore për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga lidhja e martesës, është e justifikuar që ta fitojë zotësinë e veprimit me lidhjen e martesës, para moshës 18 vjeç. Kjo do të thotë, se zotësia e veprimit e fituar në këtë mënyrë, nëpërmjet emancipimit, nuk do të humbasë edhe nëse martesa ndërpritet, pra i mituri do të vazhdojë të ketë zotësi të plotë për të vepruar.⁵⁴

Nga këto që i kemi shënuar më lart, mund të konstatojmë se ekziston mundësia e lidhjes së martesës edhe pa e arrit moshën madhore, por gjithsesi duhet kaluar nëpër procedurat që i kemi shënuar më lart.

2.2.3 Sëmundja e rëndë psikike ose zhvillimi i metë mendor

Si pengesë për lidhjen e martesave është edhe sëmundja e rëndë psikike ose zhvillimi i metë mendor. Kjo pengesë përbën ndalesë për martesë, pra ekzistenca të njëri nga bashkëshortët e ardhshëm e gjendjes së të sëmurit rëndë psikikisht ose me zhvillim të metë mendor e tillë që bënë të pamundur të kuptuarit e qëllimit të martesës është ndalesë martesore.⁵⁵ Gjendja e tillë e bën personin të paaftë për ta kuptuar qëllimin e martesës dhe, në këto rrethana, pëlqimi i tij, edhe kur shfaqet nga pikëpamja e vullnetit të jashtëm, është i metë për shkak të pamundësisë që aftësia e tij psikike ka për të kuptuar rëndësinë e veprimit konkret dhe të pasojave të tij në të ardhmen.

⁵³ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 16 paragrafi 2 dhe 3

⁵⁴ Albana Metaj-Stojanova, “Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile” në “Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetovë, 2022

⁵⁵ Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006, faqe 113

Në këto raste, heqja e zotësisë së veprimit vjen për shkak të ndonjë sëmundje psikike ose paaftësisë për të gjykuar të ndonjë personi. Sëmundjet psikike mund të jenë të natyrave të ndryshme si bie fjala skizofrenia, paranoja, deliriumet etj.⁵⁶

Mirëpo nëse konstatohet ndonjëra nga këto sëmundje, gjatë procesit të lidhjes së martesës, zyrtari i gjendjes civile, nuk duhet të lejojë lidhjen e martesës së personit me pazotësi veprimi, nëse nuk ka një vendim të gjykatës për lejimin e lidhjes së martesës.

Për të lejuar personin me pazotësi veprimi për të lidhë martesë, çdoherë kërkohet vendimi i gjykatës.⁵⁷

Zyrtari i gjendjes civile, duhet t'i këshillojë personat të cilët dëshirojnë të lidhin martesë, për tu informuar për gjendjen e tyre shëndetësore. Zyrtari nuk mund t'i detyrojë bashkëshortët e ardhshëm që të bëjnë kontrolle mjekësore. Mirëpo, në këto raste ai vetëm duhet t'i këshillojë dhe nëse nuk ka vendim prej gjykatës për marrjen e zotësisë së veprimit të ndonjërit prej bashkëshortëve, nuk ka arsye për refuzimin e lidhjes së martesës. Dhe në të kundërtën, kur konstatohet se njëri nga bashkëshortët është i privuar nga zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës, atëherë duhet të refuzohet kërkesa për lidhjen e martesës.

Gjithashtu, martesa mund të anulohet nëse ndërkohë ndonjëri nga bashkëshortët nuk ka aftësi për të vepruar për shkak të sëmundjes psikike të diagnostikuar apo shkaqeve tjera që mund të ndodhin, dhe në këtë rast mund të kërkohet zgjidhja e martesës me shkurorëzim.

2.2.4 Lidhja gjinore midis bashkëshortëve

Një prej pengesave për lidhjen e martesës është edhe lidhja gjinore midis bashkëshortëve. Kjo pengesë vazhdimisht është theksuar dhe paraqitur nga autorët e ndryshëm në të drejtën familjare, por njëkohësisht është e sanksionuar si pengesë martesore edhe me dispozita ligjore të vendit tonë. Kjo pengesë martesore është përdorur nëpër periudha të ndryshme kohore, dhe gjithashtu është përdorë edhe në të drejtën zakonore shqiptare dhe është përcjell ndër breza. Ndërsa, tani në mënyrë eksplicite është e sanksionuar me Ligjin për familje të Kosovës.

Me dispozita ligjore është përcaktuar se gjinia është pengesë martesore. Si pengesë martesore është:⁵⁸

- 1) Gjinia e gjakut,

⁵⁶ Abdulla Aliu, e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 105

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Abdulla Aliu&Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 106

- 2) Gjinia e krushqisë, dhe
- 3) Gjinia e adoptimit.

Nga kjo mund të nxjerrim përfundim se këto tri lloje të gjinisë janë pengesa martesore midis bashkëshortëve.

2.2.5 Të metat në shfaqjen e vullnetit

Si pengesë martesore në mes dy bashkëshortëve është edhe mungesa e vullnetit apo të metat në shfaqjen e vullnetit. Kjo mungesë e vullnetit ekziston kur vullneti i deklaruar i dy bashkëshortëve nuk përputhet me vullnetin e vërtetë.

Shkak i kësaj mungese është deklarimi i vullnetit me dhunë, kanosje, mashtrim ose lajthim.⁵⁹ Mungesa e vullnetit të bashkëshortëve është cilësuar edhe nga legjislacioni pozitiv si pengesë martesore, dhe nëse konstatohet se ekziston, atëherë si pasojë ka anulimin e martesës.

Dhe në rastin konkret, martesë nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.⁶⁰

Sipas dispozitave ligjore të vendit tonë, kur vërtetohet mungesa e vullnetit në momentin e lidhjes së martesës, zyrtari i gjendjes civile nuk do të lejojë lidhjen e martesës. Në qoftë se martesë është lidhur ende pa u zbuluar mungesa e vullnetit, dhe ndërkohë vërtetohet mungesa e vullnetit, atëherë kjo është shkak për të kërkuar anulimin e martesës.

Shkaqet që e bëjnë një martesë të lidhur në kushtet e mungesës së vullnetit të lirë janë dhënia e deklaratës së vullnetit nën ndikimin e lajthitjes, mashtrimit, dhunës dhe kanosjes.

Duke përfunduar mund të theksojmë se këto janë katër kategori të cilat mund të ndikojnë në vullnetin e bashkëshortëve, ekzistimi i të cilave do ta anulonte lidhjen e martesës.

2.3 Procedura për lidhjen e martesës (kurorëzimit)

Procedura për lidhje të martesës konsiderohet edhe si akti final i lidhjes së martesës, e që në opinion njihet më shumë si akti i kurorëzimit. Kurorëzimi nënkupton tërësinë e veprimeve që mundësojnë drejtpërsëdrejti lidhjen e martesës.⁶¹

⁵⁹ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 97

⁶⁰ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 18

⁶¹ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 121

Kurorëzimi bëhet në formë civile dhe është me ligj i paraparë si formë e detyrueshme. Kurorëzimi bëhet tek organi kompetent, në mënyrë publike dhe solemne dhe në vendin e caktuar.

Mirëpo, para se të vijmë te akti i lidhjes së martesës, duhet të plotësohen edhe disa kushte që janë të parapara me legjislacionin e Kosovës.

Sipas akteve nënligjore për lidhjen e martesës (kurorëzimet) në Republikën e Kosovës, parashihen tri lloje të dokumentacionit:⁶²

- Dokumentet për lidhjen e martesës për shtetasit e Kosovës,
- Dokumentet për lidhjen e martesës për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë edhe shtetësi tjetër, dhe
- Dokumentet për lidhjen e martesës për shtetasit e huaj.

Dokumentet për lidhjen e martesës përshtetasit e Kosovës, ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm duhet të ofrojë dokumentet si në vijim:⁶³

- Kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile, për të dy bashkëshortët;
- Certifikata e gjendjes martesore;

Nëse shtetasi i Republikës së Kosovës është me vendbanim jashtë Republikës së Kosovës, i kërkohet vërtetimi i vendbanimit në të cilin dëshmohet gjendja martesore ose deklaratë e vërtetuar nga noteri i atij vendi, apo dokument tjetër të lëshuar nga institucioni kompetent i atij shteti, e cila dëshmon gjendjen martesore të tij.

Dokumenti duhet të jetë i përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nëse shtetasi është nën moshën madhore, kërkesës për lidhje të martesës duhet t'i bashkëngjitet edhe vendimi i gjykatës që lejon lidhjen e martesës.

Për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë edhe shtetësi tjetër për lidhjen e martesës kërkohen dokumentet si në vijim:⁶⁴

- Kopja e vlefshme e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës dhe kopja epasaportës së vlefshme e shtetit tjetër;
- Shteti i cili e lëshon certifikatën e kapacitetit martesor, t'i kërkohet edhe kjo certifikatë;

⁶² Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes

⁶³ Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes, neni 12

⁶⁴ Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes, neni 13

- Shteti i cili e lëshon deklaratën nën betim, t'i kërkohet kjo deklaratë
- Shteti i cili e lëshon vetëm vërtetimin e vendbanimit t'i kërkohet ky dokument.

Nëse ndonjë shtet e vërteton me dëshmi se nuk lëshon asnjërin nga dokumentet e përcaktuara sipas dispozitave të lartcekura, atëherë duhet të merret për bazë ndonjë dokument tjetër i gjendjes civile i cili dëshmon gjendjen martesore të personit.

Dokumentet për lidhjen e martesës për shtetasit e huaj nevojiten si në vijim:⁶⁵

- Kopja e pasaportës së vlefshme e shtetasit të huaj;
- Leja e hyrjes në Republikën e Kosovës, për shtetasit e atyre shteteve që Republika e Kosovës aplikon regjimin e vizave;
- Leja e qëndrimit në Republikën e Kosovës, nëse të dy bashkëshortët janë shtetas të huaj;
- Certifikata e lindjes ose dokument i barasvlershëm që vërteton të dhënat e lindjes;
- Shteti i cili e lëshon certifikatën e kapacitetit martesor, t'i kërkohet kjo certifikatë;
- Shteti i cili e lëshon deklaratën nën betim, t'i kërkohet kjo deklaratë;
- Shteti i cili e lëshon vetëm vërtetimin e vendbanimit, t'i kërkohet ky dokument.

Nëse ndonjë shtet e vërteton me dëshmi se nuk lëshon asnjërin nga dokumentet e përcaktuar sipas dispozitave të këtij neni, atëherë duhet të merret për bazë ndonjë dokument tjetër i gjendjes civile i cili dëshmon gjendjen martesore të personit.

Kur plotësohen kushtet nga secila nga këto kategori të lartcekura për lidhjen e martesës, atëherë kërkesa parashtrohet në zyrën e gjendjes civile në komunën përkatëse.

Dhe, njëri nga bashkëshortët e ardhshëm mund të bëjë kërkesë për shpalljen e martesës, pasi të kenë prezantuar të gjitha dokumentet dhe vetëm pasi zyrtari i gjendjes civile të sigurohet se dokumentet janë në rregull.

Në rast se zyrtari i gjendjes civile, konstaton mos ekzistimin e pengesave dhe ndalesave për lidhjen e martesës, atëherë pas kalimit të afati prej 24 orë pune, nga shpallja e martesës, mund të fillojë procedurën e regjistrimit të martesës.⁶⁶

Në Zyrën e Gjendjes Civile duhet të jenë prezent të dy bashkëshortët e ardhshëm, dy dëshmitarët dhe përkthyesi, nëse njëri nga bashkëshortët është shtetas i huaj.

Nëse njëri ose të dy bashkëshortët janë shurdhmemecë, duhet që vetë palët ta sigurojnë interpretin për shurdhmemecë gjatë lidhjes së martesës.⁶⁷

⁶⁵ Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes, neni 14

⁶⁶ Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes, neni 15.

⁶⁷ Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes,

Për regjistrimin e aktit të martesës, nevojiten dokumentet si në vijim:⁶⁸

- Kopjet e dokumenteve të vlefshme të identifikimit të të dy bashkëshortëve;
- Kopjet e dokumenteve të vlefshme të identifikimit të të dy dëshmitarëve;
- Kopja e dokumentit të vlefshëm të identifikimit të përkthyesit, nëse përkthyesi është i domosdoshëm;
- Kopja e dokumentit të vlefshëm të identifikimit të interpretit për shurdhmemec, nëse interpreti është i domosdoshëm;
- Deklarata për vendbanimin dhe shtetësinë e bashkëshortëve.

2.3.1 Procedura paraprake

Para se të bëjmë lidhjen e martesës duhet patjetër që të bëjmë disa procedura paraprake. Këto procedura kanë për qëllim që paraprakisht të bëhen të gjitha përgatitjet e lidhjes së martesës. Në këto veprime procedurale përfshihet paraqitja e vullnetit për lidhje të martesës nga personat që dëshirojnë të lidhin martesë.

Shprehja e vullnetit të personave që kanë për qëllim lidhjen e martesës, bëhet me parashtrimin e kërkesës për lidhjen e martesës në formën e paraparë me ligj. Sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, personat që dëshirojnë të lidhin martesë duhet të paraqesin kërkesën pranë ofiqarit të kuvendit komunal. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim në formë të fletëparaqitjes ose me gojë, mirëpo në këtë rast zyrtari i gjendjes civile duhet të përpilojë procesverbal. Gjithashtu, edhe në dispozitat e ligjit të gjendjes civile është e paraparë mënyra e regjistrimit të aktit të martesës, ku thuhet që, lidhja e martesës shënohet në procesverbal të mbajtur nga zyrtari i zyrës së gjendjes civile në komunë, duke pasqyruar vullnetin e përbashkët të bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të zyrtarit të gjendjes civile, sipas legjislacionit në fuqi.⁶⁹

Paraqitja e kërkesës apo fletëparaqitjes, është veprimi i parë i procedurës për lidhje të martesës. Fletëparaqitja për lidhjen e martesës dhe dokumentet tjera të nevojshme, paraqiten te zyrtari i gjendjes civile.

Kërkesa përmban shënime siç janë: emri, mbiemri, datëlindja, vendbanimi, shtetësia etj., si dhe deklaratën e bashkëshortëve të ardhshëm që dëshirojnë të lidhin martesë me vullnetin e tyre të lirë.⁷⁰ Në kërkesë duhet të shënohet se dy bashkëshortët nuk kanë kurrfarë pengesa ose ndalesa

Martësës dhe Vdekjes, neni 15.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, neni 41

⁷³ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 119

martesore dhe se bashkëshortët janë të informuar për gjendjen e tyre shëndetësore. Gjithashtu, preferohet që në kërkesë të paraqitet edhe mbiemri i ardhshëm i bashkëshortëve, dhe të paraqitet edhe certifikata e gjendjes martesore. Nëse martesa e mëparshme ka pushuar me anulim, shkurrezë, me vdekje, atëherë është e nevojshme paraqitja edhe e dokumenteve tjera me të cilat argumentohen këto fakte (aktet relevante nga gjendja civile).⁷¹

Kur, fletëparaqitje për lidhje të martesës ka bërë personi i moshës jo madhore, atëherë kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe vendimi i gjykatës për lejimin e lidhjes së martesës.

Pas parashtrimit të kërkesës për lidhjen e martesës, ofiqari do t'u rekomandojë personave që dëshirojnë të lidhin martesë që deri në datën e lidhjes së martesës, në mënyrë të ndërsjellët të informohen lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore, të vizitojnë konsulentin familjar për të siguruar mendimin profesional përkitazi me zhvillimin e marrëdhënieve harmonike martesore dhe familjare, të njihen me mundësitë dhe përparësitë e planifikimit të familjes, si dhe të pajtohen lidhur me mbiemrin e ardhshëm.⁷²

Zyrtari i gjendjes civile, duhet t'i shqyrtojë të gjitha dokumentacionet relevante të bashkëshortëve dhe të kujdeset për vlefshmërinë e tyre. Pastaj zyrtari gjithsesi duhet të sigurohet se nuk ka pengesa dhe ndalesa martesore. Nëse haset në to, zyrtari i gjendjes civile, është i detyruar ta refuzojë lidhjen e martesës, sepse kjo parashihet edhe me dispozita të Ligjit për Familje të Kosovës.

Në rast kur Zyrtari i gjendjes civile, vërteton se ka mungesa në dokumentacion, përkatësisht në plotësimin e kushteve për lidhjen e martesës dhe njëkohësisht konstaton se ka pengesa dhe ndalesa martesore, e refuzon lidhjen e martesës duke ia komunikuar vendimin me gojë parashtruesve të kërkesës, si dhe harton procesverbal për këtë çështje.

Në procesverbal Zyrtari i gjendjes civile shënon: a) arsyen e refuzimit për lidhjen e martesës; b) pengesën për të cilën refuzohet lidhja e martesës; c) personat për të cilët refuzohet lidhja e martesës; d) data dhe vendi ku është kërkuar lidhja e martesës; e) emri dhe mbiemri i zyrtarit të gjendjes civile që e ka refuzuar lidhjen e martesës.⁷³

Personat që kanë paraqitur kërkesën për lidhjen e martesës, nëse nuk pajtohen me komunikimin verbal të vendimit për refuzimin e kërkesës për lidhjen e martesës, mund të kërkojnë nga Zyrtari i gjendjes civile të nxjerr aktvendimin me shkrim. Parashtruesit e kërkesës mund të bëjnë ankesë brenda 8 ditëve nga data e komunikimi për vendimin e refuzimit të kërkesës për mos lejimin e

⁷¹ Po aty.

⁷² Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 26

⁷³ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 120

lidhjes së martesës së tyre. Ndërsa, lidhur me ankesën e tyre organi kompetent duhet të vendosë në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës.

2.3.2 Lidhja e martesës përpara organit kompetent

Kur janë plotësuar të gjitha kushtet dhe nuk ka pengesa dhe ndalesa për lidhje të martesës, zyrtari i gjendjes civile cakton vendin, kohën dhe datën për lidhje të martesës.

Akti i lidhjes së martesës fillon me paraqitjen e raportit të zyrtarit të gjendjes civile, vërtetimin e identitetit dhe të prezencës të dhëndrit dhe nuses, si dhe të dëshmitarëve dhe me deklarimin e tyre se nuk ka ndonjë pengesë apo ndalesë martesore sipas Ligjit për Familje të Kosovës.⁷⁴

Dhe, kur zyrtari gjendjes civile konstaton këto fakte, ai dhëndrit dhe nuses ua shpjegon të drejtat dhe detyrat që rezultojnë për ta nga martesa dhe marrëdhëniet që burojnë prej saj, si bashkëshortë e si prindër të ardhshëm, duke ua lexuar edhe dispozitat ligjore, përkatësisht deklaratën solemne për lidhje të martesës.

⁷⁴ Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2011, faqe 98



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of
Internal Affairs
Agjencia e Regjistrimit Civil/Civil Registration Agency/Agencija Civilnu Registraciju

DEKLARATË SOLEMNE ME RASTIN E LIDHJES SË MARTESËS

Po ju lexojmë deklaratën solemne për obligimet ligjore që i keni me hyrjen në martesë.

Në bazë të Ligjit nr.2004/32 mbi Familjen i Kosovës do t'ju lexojmë dispozitat ligjore lidhur me të drejtat dhe obligimet ndaj njëri-tjetrit (nenet 65, 66, 67, 68, 69, 70, 287 paragrafi I, 320 paragrafi I. dhe neni 402):

Secili bashkëshort është i lirë që t'i zhvillojë aftësitë dhe prirjet e veta punuese, shpirtërore etj., dhe që në mënyrë të pavarur të hyjë në të gjitha format e jetës shoqërore.

Bashkëshortët kanë për detyrë që të zhvillojnë ndjenjën e solidaritetit reciprok, si dhe të solidaritetit ndaj anëtarëve të tjerë të familjes e sidomos ndaj fëmijëve të vet të lindur ose të adaptuar.

Bashkëshortët janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pasurore. Bashkëshortët kanë për detyrë që të jenë besnik ndaj njëri-tjetrit dhe reciprokisht ta ndihmojnë dhe të respektojnë njëri-tjetrin.

Bashkëshortët caktojnë me marrëveshje vendin e vendbanimit të tyre. Për mbajtjen e ekonomisë së përbashkët familjar vendosin me marrëveshje-bashkëshortët.

Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e përbashkët dhe e veçantë.

Bashkëshorti që nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim, që është i paaftë për punë ose nuk mund të punësohet ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti i tij në pajtim me mundësitë e tij. Pasuria, të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë lidhjes martesore, si dhe të hyrat nga ajo pasuri, është pasuri e tyre e përbashkët.

Dhëndrri:_____Nusja:_____.

Vendi_____më datë_____.

Dëshmitarët:

1._____

2._____

Zyrtari i Gjendjes Civile

(emri personal, nënshkrimi dhe vula)



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal
Affairs
Agjencia e Regjistrimit Civil/Civil Registration Agency/Agencija Civilnu Registraciju

PASI JU ËSHTË LEXUAR DEKLARATA SOLEMNE

**NË PYETJET E PARASHTRUARA, JU (PËR DËSHMITARËT DHE BASHKËSHORTËT), DO TËPËRGJIGJENI ME ZË
DHE KUPTUESHËM “PO OSE JO,,**

Dëshmitarët:

A i njihni personat prezent që kanë shpallur martesën dhe vërtetoni se nuk ka pengesa për lidhjen e martesës?

A ka ndonjëri prej jush vërejtje për gjendjen shëndetësore të personave prezent që kanë shpallur martesën që mund të paraqes pengesë në lidhjen e martesës?

Bashkëshortët:

**dhëndri _____ a po lidhni martesë me dëshirën tuaj me shoqene
cila është prezentë?**

**Nusja _____ a po lidhni martesë me dëshirën tuaj me shokun icili është
prezent?**

A po lidhni martesë lirisht dhe me dëshirën e juaj?

Mos po lidhni martesë në mënyrë të detyrueshme apo në lajthim ndaj bashkëshortit,
përkatësisht bashkëshortes?

Mos jeni në gjini gjaku dhe mos ekziston në mes jush pengesë ose ndalesë ligjore për lidhjene
martesës ?

A jeni marrë vesh për gjendjen shëndetësore të njëri-tjetrit?

Bashkëshortët me rastin e lidhjes së martesës mund të merren vesh lidhur me mbiemrin, të marrin mbiemrin e njërit ose të bashkëshortit tjetër, ose të mbajnë çdonjëri mbiemrin e vetë, ose që çdonjëri prej tyre mbiemrit të vetë t'ia shtojë mbiemrin e bashkëshortit tjetër ose që njëri bashkëshort ta marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër dhe këtij mbiemri t'i shtojë mbiemrin e vetë.

dhëndrri:_____ cilin mbiemër do ta merrni?

_____.

nusja:_____cilin mbiemër do ta merrni?

_____.

në emër të komunës së _____ **konstatoj** se në ditën e sotme

date _____ është lidhur martesa në mes

_____ dhe _____.

më datë, _____ të vitit _____.

dëshmitarët:

1. _____

2. _____

Zyrtari i Gjendjes Civile

(emri personal, nënshkrimi dhe vula)

Pastaj, zyrtari i gjendjes civile, pyet secilin bashkëshort veç e veç, nëse pëlqejnë të martohen me njëri tjetrin. Dhe, në qoftë se dhëndri dhe nusja deklarojnë në mënyrë afirmative “po” vullnetin e lirë për lidhjen e martesës, ai e shpall martesën të lidhur sipas Ligjit për Familje i Kosovës.⁷⁵

⁷⁵ Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2011, faqe 99

2.4 Regjistrimi i kurorëzimeve në librat amzë

Pas shpallje së martesës (kurorëzimit) nga zyrtari i gjendjes civile, personat e martuar duhet të regjistrohen në librin amzë të të martuarave. Kjo çështje është e rregulluar me dispozita ligjore në vendin tonë, ku janë të përcaktuara veprimet me rastin e lidhjes së martesës, dhe sipas këtyre deponitave; akti i lidhjes së martesës regjistrohet në regjistrin themeltar të lindjes të secilit bashkëshort, kur ata e kanë regjistrin në të njëjtën zyrë. Kur njëri ose të dytë e kanë regjistrin themeltar në një zyrë tjetër, atëherë zyrtari i gjendjes civile i autorizuar e bën njoftimin tek zyra/zyrat përkatëse për të dhënat që përmban akti i martesës.⁷⁶

Gjatë regjistrimit në librin amzë për lidhje të martesës duhet të regjistrohen këto fakte për dhëndrin dhe nuses: a) emri dhe mbiemri; b) viti i lindjes; c) numri personal; c) deklarata për mbiemrin (mbiemrin martesor); d) data dhe vendi i lidhjes së martesës; dh) vendbanimi dhe adresa e të martuarave; e) adresa para lidhjes së martesës; ë) emri dhe mbiemri i prindërve të dhëndrit dhe nuses; f) emri, mbiemri dhe adresa e dëshmitarëve dhe g) emri dhe mbiemri i personit zyrtar para të cilit është lidhur martesa.⁷⁷

Nëse gjatë lidhjes së martesës ka marrë pjesë edhe përkthyes, atëherë edhe ai duhet të shënohet në rubrikën e veçantë të librit amzë. Në qoftë se, gjatë lidhjes së martesës bashkëshorti është pajtuar për ndërrimin e mbiemrit, atëherë zyrtari i gjendjes civile duhet edhe deklaratën e tij ta regjistrojë në rubrikë të veçantë. Pastaj, Zyrtari i Gjendjes Civile e regjistron lidhjen e martesës në librin amzë të të martuarave dhe atë në të njëjtën libër nënshkruhen bashkëshortët, dëshmitarët dhe zyrtari i gjendjes civile. Kjo formë e regjistrimit është praktikuar deri në fund të vitit 2012.

Sepse, prej fillimit të vitit 2013, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Gjendjen Civile, Zyrtari i Gjendjes Civile, pasi sigurohet për identitetin e bashkëshortëve, dëshmitarëve dhe përkthyesit/interpretit nëse ka, plotëson aktin e martesës në regjistrin qendror të gjendjes civile. Ky akt plotësohet dhe pasqyrohet me akt të veçantë në formë elektronike dhe të shtypur vetëm nga zyrtari i gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lidhjes së martesës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.⁷⁸ Aktet e tilla mbahen, për secilin rast, të renditura kronologjiket.

⁷⁶ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, neni 45

⁷⁷ Abdulla Aliu&Haxhi Gashi e Drejta Familjare, Prishtinë 2007, faqe 122-123.

⁷⁸ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, neni 20, pika 1.

Zyrtari shtyp paraprakisht një kopje të aktit dhe kërkon nga pala të konfirmoj saktësinë e të dhënave. Pas konfirmimit të saktësisë së të dhënave nga pala, zyrtari i gjendjes civile shtyp aktin e martesës. Edhe Akti i martesës nënshkruhet nga të dy bashkëshortët, të dy dëshmitarët, nga përkthyesi / interpreti nëse ka, dhe në fund nënshkruhet dhe vulozet nga zyrtari i gjendjes civile. Zyrtari i gjendjes civile shtyp certifikatën e martesës me të cilën pajisen bashkëshortët. Zyrtari i gjendjes civile krijon një dosje me të gjitha dokumentet e paraqitura për regjistrimin e martesës.

Për martesën e lidhur në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, sipas rasteve, vlejné rregullat e përcaktuara sipas dispozitave ligjore të vendit tonë.

Pasi t'i ketë siguruar deklaratat mbi pajtimin për hyrjen në martesë, zyrtari i gjendjes civile e shpall martesën të lidhur.

Akti i martesës përmban të dhënat ashtu siç është përcaktuar në dispozitat e Ligjit për Gjendjen Civile.

Akti i martesës për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Republikën e Kosovës, mbahen në Zyrën e gjendjes civile. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i Zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin qendror të gjendjes civile.⁷⁹

Akti i martesës, të mbajtura jashtë shtetit, në shërbimin diplomatik apo konsullor të Republikës së Kosovës, për shtetasit e Republikës së Kosovës apo dhe për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcillen nëpërmjet Ministrisë së punëve të jashtme në Agjenci, deri me datën 20 janar të vitit të ardhshëm.⁸⁰

⁷⁹ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, neni 20, pika 2.

⁸⁰ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, neni 20, pika 3.

Kapitulli III


III. TË DHËNA MBI MARTESAT E LIDHURA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT NË PERIUDHËN 2012-2022

3.1. Prezantimi i rezultateve për periudhën 2012-2022

	Lidhja e martesave për vitin 2012												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	14	14	20	13	12	12	7	13	13	17	8	22	165
Mosha mes. e meshkujve	30.4	29.2	30.6	31.9	29.5	29.5	27	26.3	25.6	29.1	27.2	27	28.6
Mosha mes. e femrave	27	25.6	26.4	27.8	25	26.4	24.2	23.1	24.6	24.9	22	23.1	25.0
Mesatarja e kurorëzimeve	28.7	27.4	28.5	29.8	27.2	27.9	25.6	24.7	25.1	27	24.6	25.0	26.8


3.1.1 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2012

Tabela 1. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2012⁸¹



⁸¹ Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2012.

Grafiku 1. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2012



Grafiku 1.1. Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve

Përmes diagrameve në grafikët e lartshënuar kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2012. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.


Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 165 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 28.6 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare në këto kurorëzimeve është 25 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 26.8 vjeç.

Lidhje të martesave në këtë vit, më së shumti janë realizuar në muajin dhjetor, e ndjekur nga muaji mars, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin korrik, përkatësisht nëntor.

	Lidhja e martesave për vitin 2013												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	19	7	11	19	13	11	13	15	11	16	10	14	159
Mosha mes. e meshkujve	31.4	29	38.8	31.2	26.3	30.8	32.5	34.1	30.3	31.1	31.6	26.3	31.1
Mosha mes. e femrave	26.6	23.8	33.9	29.5	25.3	27.8	27.5	29.2	27.1	27.5	26.3	23.7	27.3
Mesatarja e kurorëzimeve	29	26.4	36.3	30.3	25.8	29.3	30	31.6	28.7	29.3	28.9	25	29.2


3.1.2 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2013

Tabela 2. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2013⁸²



⁸² Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2013.

Grafiku 2. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2013



Grafiku 2.1. Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët e lartshënuar kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2013. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 159 kurorëzime. Moshë e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31.1 vjeç, ndërsa për femrat moshë mesatare është 27.3 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 29.2 vjeç. Në këtë vit, kurorëzimeve më së shumti janë realizuar në muajin janar përkatësisht prill, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin shkurt, përkatësisht nëntor.

	Lidhja e martesave për vitin 2014												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	Dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	12	12	13	2	11	11	9	20	14	10	18	31	162
Mosha mes. e meshkujve	30.6	29.1	33.5	31	32.6	33.5	33.4	30.5	32.7	29.1	29.8	30.6	31.3
Mosha mes. e femrave	26.3	28.2	29.6	29	28.9	28.6	29.6	26.9	29.0	24.1	26.9	26.6	27.6
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.4	28.6	31.0	30	30.7	31.0	31.5	28.7	30.8	26.5	28.3	28.6	29.4


3.1.3 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2014

Tabela 3. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2014⁸³



⁸³ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2014

Grafiku 3. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2014



Grafiku 3.1. Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët e lartshënuar kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2014. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 162 kurorëzime. Moshë mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31.3 vjeç, ndërsa për femrat moshë mesatare është 27.6 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 29.4 vjeç. Në këtë vit, kurorëzimeve më së shumti janë realizuar në muajin dhjetor përkatësisht gusht, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin prill, përkatësisht tetor.

3.1.4 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2015


	Lidhja e martesave për vitin 2015												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	13	21	9	9	14	10	6	15	15	15	8	12	147
Mosha mes. e meshkujve	30.2	33.3	30.5	28.2	32.4	29	27.3	31.6	30	35.3	31.7	32.8	31.0
Mosha mes. E femrave	25.9	29.0	26.8	24.5	30.1	24.5	26	28.6	26	30	26.5	29.6	27.2
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.0	31.1	28.6	26.3	31.2	26.7	26.6	30.1	28	32.6	29.1	31.2	29.1

Tabela 4. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2015⁸⁴



Grafiku 4. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2015

⁸⁴ Drejtorja e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2015



Grafiku 4.1. Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 4 dhe 4.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2015. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 147 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 27.2 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 29.1 vjeç. Në këtë vit, kurorëzimeve më së shumti janë realizuar në muajin gusht, shtator dhe tetor ndërsa më së paku janë realizuar në muajin korrik, përkatësisht nëntor.

3.1.5 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2016


	Lidhja e martesave për vitin 2016												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qersho r	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	Dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	9	12	11	11	8	7	11	18	14	12	13	17	143
Mosha mes. e meshkujve	32.5	31.8	26.5	32.7	31.7	30.8	33.7	32.8	33.4	27.2	29.1	34	31.5
Mosha mes. e femrave	25.8	28.2	24.2	29.9	24.8	26	29.8	28.8	27.8	24.7	23.3	30.2	26.9
Mesatarja e Kurorëzimeve	29.1	30	25.3	31.3	28.2	28.4	31.7	30.8	30.6	25.9	26.2	32.1	29.2

Tabela 5. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2016⁸⁵



Grafiku 5. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2016

⁸⁵ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2016



Grafiku 5.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 5 dhe 5.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2016. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 143 kurorëzime. Moshë mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31.5 vjeç, ndërsa për femrat moshë mesatare është 26.9 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 29.2 vjeç. Në këtë vit, kurorëzimeve më së shumti janë realizuar në muajin gusht, përkatësisht dhjetor, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin qershor, përkatësisht maj.

3.1.6 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2017


	Lidhja e martesave për vitin 2017												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	16	17	11	12	14	12	5	20	15	17	7	10	156
Mosha mes. e meshkujve	30.6	29.4	31.2	30	35.1	30.1	28.4	31	29.4	30.6	34.2	32.4	31
Mosha mes. e femrave	26.5	26.1	25.6	28.6	29.7	25.6	24.2	27.4	25.1	26.9	28.7	28.1	26.8
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.5	27.7	28.4	29.3	32.4	27.8	26.3	29.2	27.2	28.7	31.4	30.2	28.9

Tabela 6. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2017⁸⁶



Grafiku 6. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2017

⁸⁶ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2017



Grafiku 6.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 6 dhe 6.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2017. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 156 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 26.8 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 28.9 vjeç. Në këtë vit, kurorëzimeve më së shumti janë realizuar në muajin gusht, përkatësisht shkurt, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin korrik, përkatësisht mentor.

3.1.7 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2018


	Lidhja e martesave për vitin 2018												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	20	10	9	15	9	10	14	12	10	11	13	13	144
Mosha mes. e meshkujve	31.5	30.7	29.6	31.4	31.2	32.4	29.7	28.6	33.2	32.7	27.2	29.3	30.6
Mosha mes. E emrave	26.9	27.2	26.6	29.4	29	26.7	25,0	26.1	27.1	27.9	25.1	26.1	26.9
Mesatarja e Kurorëzimeve	29.2	28.9	28.1	30.4	30.1	29.5	27.3	27.3	29.6	30.3	26.1	27.7	28.7

Tabela 7. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2018⁸⁷



Grafiku 7. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2018

⁸⁷ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2018



Grafiku 7.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 7 dhe 7.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2018. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 144 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 30.6 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 26.9 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 28.7 vjeç. Gjatë këtij viti, kurorëzime, më së shumti janë realizuar në muajin janar, përkatësisht prill, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin mars, përkatësisht maj.

3.1.8 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2019


	Lidhja e martesave për vitin 2019												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	Nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	14	8	12	17	15	6	13	31	18	10	10	8	162
Mosha mes. e meshkujve	30.3	32.1	30.5	30.2	32.8	39.5	27	31.4	31.0	29	32.5	28.6	31.2
Mosha mes. E emrave	27.6	25.5	27.1	26.5	28.8	35	23.9	26.9	27.4	25.6	28.5	25	27.3
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.9	28.8	28.8	28.4	30.8	37.2	25.4	29.1	29.2	27.3	30.5	26.8	29.2

Tabela 8. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2019⁸⁸



Grafiku 8. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2019

⁸⁸ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2019



Grafiku 8.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 8 dhe 8.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2019. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 162 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 31.2 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 27.3 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vite është 29.2 vjeç. Gjatë këtij viti, kurorëzime më së shumti janë realizuar në muajin shtator, përkatësisht prill, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin qershor, të pasur nga muajt: shkurt dhe dhjetor.

3.1.9 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2020


	Lidhja e martesave për vitin 2020												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	12	11	7	4	2	7	12	14	10	11	4	18	112
Mosha mes. e meshkujve	30.3	30.5	32.1	32.7	26.5	27.7	30.6	29.4	30.1	30.1	21	30.1	29.2
Mosha mes. e femrave	25.9	26.3	25.7	27.5	27	26.1	25.6	26.1	27.4	26.5	22.2	25.5	25.9
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.1	28.4	28.9	30.1	25.7	26.9	28.1	27.7	28.7	28.3	21.6	27.8	27.5

Tabela 9. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2020⁸⁹



Grafiku 9. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2020

⁸⁹ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2020



Grafiku 9.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 9 dhe 9.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2020. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 112 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 29.2 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 25.9 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 27.5 vjeç. Gjatë këtij viti, kurorëzime më së shumti janë realizuar në muajin dhjetor, përkatësisht gusht, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin qershor, të pasur nga muajt: maj, prill dhe nëntor.

3.2 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2021


	Lidhja e martesave për vitin 2021												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	7	13	10	8	6	10	16	14	6	14	8	8	120
Mosha mes. e meshkujve	30.4	30.1	27.3	27.6	33.5	26.7	30.8	31.1	31	28.8	30.3	27.6	29.6
Mosha mes. e femrave	27	28.2	23	24.1	29.8	24	27.4	28.5	25.8	25.5	28.7	25	26.4
Mesatarja e Kurorëzimeve	28.7	29.1	25.1	25.8	31.6	25.3	29.1	29.8	28.4	27.1	29.5	26.3	28

Tabela 10. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2021⁹⁰



Grafiku 10. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2021

⁹⁰ Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2021



Grafiku 10.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve


Përmes diagrameve në grafikët 10 dhe 10.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të komunës së Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2021. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 120 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 29.6 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 26.4 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 28 vjeç. Gjatë këtij viti, kurorëzime më së shumti janë realizuar në muajin korrik të pasuar nga muaji gusht dhe tetor, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin maj, përkatësisht shtator.

3.2.1 Kurorëzimet dhe libri amzë për vitin 2022


	Lidhja e martesave për vitin 2022												
Muajt:	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	totali
Nr. i lidhjeve të martesave	18	14	8	10	9	12	17	12	7	17	11	9	144
Mosha mes. e meshkujve	32	29.6	24.6	27.6	30.8	30.1	30.7	29.3	33.1	32.1	28.3	27.4	29.6
Mosha mes. e femrave	27.7	26.8	22.1	24	24.1	27.7	26	24.6	28.4	27.1	25.3	22.5	25.1
Mesatarja e kurorëzimeve	29.8	28.2	23.3	25.8	27.4	28.9	28.3	26.9	30.7	29.6	26.8	25.0	27.3

Tabela 11. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për vitin 2022⁹¹



Grafiku 11. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve për periudhën janar-dhjetor 2022

⁹¹ Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, K. Kaçanik, raporti 2022



Grafiku 11.1 Numri i kurorëzimeve me moshën mesatare të gjinive dhe mesatarja e të kurorëzuarve

Përmes diagrameve në grafikët 11 dhe 11.1, kemi paraqitur rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë të qytetit të Kaçanikut, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, për periudhën janar-dhjetor 2022. Janë prezantuar të gjitha lidhjet e martesave për këtë vit, duke llogaritur edhe moshën mesatare të meshkujve për çdo muaj, moshën mesatare të femrave, si dhe mesataren e përbashkët të kurorëzimeve.

Nga rezultatet e paraqitura edhe përmes diagrameve, në këtë vit kemi 144 kurorëzime. Mosha e mesatare e meshkujve gjatë këtyre kurorëzimeve për këtë vit është 29.6 vjeç, ndërsa për femrat mosha mesatare është 25.1 vjeç. Ndërkaq, mesatarja vjetore e kurorëzimeve për këtë vit është 27.3 vjeç. Gjatë këtij viti, kurorëzime më së shumti janë realizuar në muajin janar përkatësisht tetor, ndërsa më së paku janë realizuar në muajin shtator, përkatësisht mars.

3.2.2 Numri i kurorëzimeve sipas viteve

	Lidhja e martesave për vitin 2012-2022										
Vitet:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i kurorëzimeve	165	159	162	147	143	156	144	162	112	120	144

Tabela12. Rezultatet e kurorëzimeve sipas librit amzë për periudhën 2012-2022



Grafiku 12.1. Paraqitja e rezultateve përmes diagrameve sipas viteve për periudhën 2012 - 2022


Në grafikët 12 dhe 12.1 , janë paraqitur rezultate e të kurorëzuarve ne qytetin e Kaçanikut me vlera numerike sipas viteve, dhe gjithashtu edhe përmes diagrameve. Gjatë prezantimit të rezultateve shohim se; viti 2012, ka numrin me te madh te kurorëzimeve e pasuar me vinin 2019.

Ndërsa, numri me më së paku të çifteve që e kanë legalizuar martesën në këtë qytet është regjistrua në vitin 2020, e pasuar me vitin 2021.

3.2.3 Mosha e mesatare e meshkujve sipas viteve

	Lidhja e martesave për vitin 2012-2022										
Vitet:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mosha e mesatare meshkujve	28.6	31.1	31.3	31.0	31.5	31	30.6	31.2	29.2	29.6	29.6

Tabela 13. Paraqet moshën mesatare të meshkujve sipas viteve të të kurorëzuarit.



Grafiku 13.1. Paraqitja e moshës mesatare të meshkujve sipas viteve për periudhën 2012-2022


Duke përdorur diagramet, në grafikët 13 dhe 13.1, kemi paraqitur moshën mesatare të meshkujve gjatë kurorëzimeve në qytetin e Kaçanikut, për më shumë se një dekadë.

Nga diagramet që pasqyrojnë vlerat reale të kurorëzimeve të realizuara në këtë qytet për këtë periudhë kohore, mund të konstatojmë se; të rinjtë e Kaçanikut e respektojnë institucionin e familjes dhe të martesës, duke iu përgjigjur dispozitave juridike dhe rregullave familjare dhe me vullnetin e pajtueshmërisë, kanë finalizuar kurorëzimet e tyre. Gjatë realizimit të lidhjeve martesore ka shume faktorë që mund të ndikojnë në këto lidhje mes dy seksëve, mosha mesatare e meshkujve që janë martuar në këtë qytet, për përudhen 2012-2022, është 30.4 vjeç.

3.2.4 Mosha e mesatare e femrave sipas viteve

	Lidhja e martesave për vitin 2012-2022										
Vitet:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mosha mesatare e femrave	25.0	27.3	27.6	27.2	26.9	26.8	26.9	27.3	25.9	26.4	28.1

Tabela 14. Paraqet moshën mesatare të femrave sipas viteve të të kurorëzuarit



Grafiku 14.1. Paraqitja e moshës mesatare të femrave sipas viteve për periudhën 2012-2022

Përmes diagrameve në grafikët 14 dhe 14.1, kemi paraqitur moshën mesatare të femrave gjatë kurorëzimeve në qytetin e Kaçanikut, për periudhën 2012-2022/


Prej diagrameve që pasqyrojnë vlerat reale të kurorëzimeve të realizuara në këtë qytet për këtë periudhë kohore, mund të konstatojmë se; të rejat e Kaçanikut e respektojnë institucionin e familjes dhe të martesës, për të realizuar të drejtën e tyre për të krijuar familje. Edhe pse ka shume faktorë që mund të ndikojnë në lidhjen e martesave me dy sekseve, mosha mesatare e femrave që janë martuar për më shume se një dekadë, në këtë qytet; është 26.8 vjeç.

Nga eksplorimi i moshës së gjinisë femërore, mund të konstatojmë se, kjo gjini, të drejtën për të lidhur martesë e realizon në moshën ideale.

3.2.5 Mesatarja e kurorëzimeve sipas viteve

	Lidhja e martesave për vitin 2012-2022										
Vitet:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mesatarja e kurorëzimeve	26.8	29.2	29.4	29.3	29.2	28.9	28.7	29.2	27.5	28	27.3

Tabela 15. Paraqet mesataren e kurorëzimeve sipas viteve të të kurorëzuarit



Grafiku 15.1. Paraqitja e mesatares së kurorëzimeve sipas viteve për periudhën 2012-2022

Gjatë përdorimit diameve, përmes tabelave 14 dhe 15 dhe grafikëve 14.1 dhe 15.1, kemi prezantuar moshën mesatare të dy gjinive që janë martuar në qytetin e Kaçanikut për një periudhë të gjatë kohore. Dhe, nga këto rezultate, kemi zbuluar moshën mesatare të kurorëzuarve në këtë qytet. Sipas këtyre rezultateve, moshë mesatare e kurorëzimeve më e re është në vitin 2012, me 26.8 vjeç. Ndërsa, moshë mesatare më e vjetër e të kurorëzuarve, është zbuluar me vitin 2014, me 29.4 vjeç, e pasuar me vitin 2015, me 29.3 vjeç.

Pas analizimit dhe krahasimit të këtyre rezultateve dhe nga moshë mesatare e të dy gjinive, kemi zbuluar edhe moshën mesatare të kurorëzuarve për këtë periudhë kohore në qytetin e Kaçanikut , e cila është 28.5 vjeç.

Kapitulli IV

IV. DISKUTIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Gjatë hulumtimit të tezës së masterit, për ta vërtetuar hipotezën e ngritur “Lidhja e martesës dhe librat amzë të të kurorëzuarve sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës me fokus në komunën e Kaçanikut për periudhën 2012-2022”, janë marrë rezultatet e të kurorëzuarve në qytetin e Kaçanikut, për këtë periudhë kohore.

Pas paraqitjes së rezultateve përmes tabelave, përpunimin dhe analizimin i këtyre rezultateve është bërë për çdo vit radhazi, duke i paraqitur të gjitha edhe përmes grafikëve dhe duke eksploruar numrin e kurorëzimeve, moshën mesatare të meshkujve, moshën mesatare të femrave dhe moshën mesatare e të kurorëzuarve. Analizimi dhe përpunimi i këtyre rezultateve është bërë për çdo muaj, vit dhe për periudhën dhjetëvjeçare. Të gjitha rezultatet janë marrë në qytetin Kaçanikut, përkatësisht në drejtorin e Administratës së Përgjithshme, përmes librave amzë të të kurorëzuarve, të cilat janë realizuar në përputhje me Ligjit për Gjendjen Civile të Republikës së Kosovës.

Sipas rezultateve të prezantuara në kapitullin e tretë, në vitin 2012, në qytetin e Kaçanikut janë realizuar gjithsejtë: 165 kurorëzime. Gjatë tërë këtij viti, nëpër secilën muaj kemi pasur kurorëzime. Mirëpo, numri më i madh i të kurorëzuarve është regjistruar në muajin dhjetor; me 22 raste dhe numrin më të vogël të lidhjeve të martesave, në muajin korrik; me 7 raste. Nga këto kurorëzime për këtë vit, mosha mesatare e meshkujve të kurorëzuar është 28.6 vjeç, kurse mosha mesatare e femrave të kurorëzuara në këtë vit është 25.0 vjeç. Ndërsa, mosha mesatare e të kurorëzuarve është 26.8 vjeç.

Sipas statistikave që i kemi prezantuar edhe përmes diagrameve në grafikët e lartshënuar për vitin 2012, gjithnjë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile, në këtë vit janë zbuluar tre raste të lidhjes së martesës që janë në kundërshtim me; kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj. Rasti i parë është realizuar më datë 31.07.2012, rasti i dytë ka ndodhur më datë 17.08.2012, dhe rasti i tretë është bërë me datë 05.09.2012. Në të tre rastet e paraqitura më lartë, personat e gjinisë femërore nuk e kanë plotësuar kushtin bazë për lidhje të martesës, sepse nuk e kanë pasur moshën e duhur për të bërë kurorë., por proceduar e këtyre rasteve është vazhduar pasi gjykata ka nxjerrë vendim për lejimin e këtyre martesave.

Ndërkaq, në vitin 2013, në qytetin e Kaçanikut janë realizuar gjithsejtë: 159 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është

regjistruar në muajt: janar dhe prill, me nga 19 raste të lidhjes së martesave, ndërsa numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar muajin shkurt, me 7 raste të lidhjeve të martesave. Dhe, nga këto kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31.1 vjeç dhe mosha mesatare e femrave me 27.3 vjeç. Pre rezultateve të këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 29.2 vjeç.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të gjendjes civile dhe nga rezultatet e analizuara dhe përpunuara për këtë vit, është vërtetuar se nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, i kanë respektuar normat ligjore me përpikëri.

Ndërsa, në vitin 2014, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë: 162 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajt: dhjetor me 31 raste dhe gusht 20 raste, kurse numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar muajin prill, me 2 raste të lidhjeve të martesave. Dhe, nga këto kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31.3 vjeç, dhe mosha mesatare e femrave me 27.6 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 29.4 vjeç. Nga rezultatet dhe statistikat e paraqitura, në vitin 2014, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar normat ligjore plotësisht.

Nga analizimi dhe përpunimi i rezultateve të vitit 2015, në qytetin e Kaçanikut janë realizuar gjithsejtë: 147 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajt: gusht, shtator dhe tetor me 15 raste, kurse numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar muajin korrik, me 6 raste të lidhjeve të martesave. Prej këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31.0 vjeç, dhe gjithashtu është nxjerrë edhe mosha mesatare e femrave me 27.2 vjeç. Dhe, nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 29.1 vjeç.

Në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të gjendjes civile dhe pas analizimit dhe përpunimit të rezultateve, gjatë vitit 2015, kemi një kurorëzim të realizuar më 19.10.2015, që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj. Personi i gjinisë femërore nuk e ka pasur moshën e duhur për lidhje të martesës dhe i është kërkuar vendim nga gjykata për të realizuar këtë kurorëzim. Dhe, pasi eshët nxjerrë vendimi, Zyra e Gjendjes Civile, ka vazhduar me procedurën për lidhjen e kësaj martese.

Gjatë analizimi dhe përpunimit të rezultateve të vitit 2016, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë: 143 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajt: gusht me 18 raste dhe dhjetor me 17 raste, kurse numri më i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar muajin qershor, me 7 raste të lidhjeve të martesave. Dhe, nga këto kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31.5 vjeç, dhe mosha mesatare e femrave me 26.9 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 29.2 vjeç.

Edhe në këtë vit është eksploruar një rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, i cili është realizuar me 17.05.2021. Edhe gjatë kësaj martese, personi i gjinisë femërore nuk e ka pasur moshën e duhur për lidhje të martesës dhe i është kërkuar vendim nga gjykata për të realizuar këtë kurorëzim.

Gjithashtu, edhe në këtë rast, procedurat për lidhjen e kësaj martese, kanë vazhduar pasi është nxjerrë vendimi i gjykatës.

Në vitin 2017, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë; 156 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin gusht, me 20 raste, e përcjell nga muajt: shkurt, përkatësisht tetor me nga 17 raste, kurse numri më i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar muajin korrik, me 5 raste. Dhe, nga këto kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31 vjeç, dhe gjithashtu është nxjerrë mosha mesatare e femrave me 26.8 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 28.9 vjeç.

Nga rezultatet dhe statistikat e paraqitura në vitin 2017, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar normat ligjore plotësisht.

Sipas analizave dhe paraqitjes së rezultateve të vitit 2018, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë: 124 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj.

Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin janar, me 20 raste, e përcjell nga muajt: prill me nga 15 raste, kurse numri më i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar në muajt: mars, përkatësisht maj, me 9 raste. Prej këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 30.5 vjeç, dhe gjithashtu është nxjerrë edhe mosha mesatare e femrave me 26.9 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 28.7 vjeç.

Gjithashtu, edhe në këtë vit, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar dispozitat ligjore me përpikëri.

Gjatë hulumtimit të këtij punimi, nga paraqitja e rezultateve të vitit 2019, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë: 162 kurorëzime. Edhe këtë vit, kemi kurorëzime nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin shtator, me 18 raste e përcjell nga muaji prill me nga 17 raste, kurse numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar në muajin qershor, me 9 raste. Nga numri i këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 31.2 vjeç, dhe mosha mesatare e femrave me 27.3 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 29.2 vjeç.

Gjithashtu, edhe në vitin 2019, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar normat ligjore plotësisht.

Në vitin 2020, në qytetin e Kaçanikut, janë realizuar gjithsejtë; 112 kurorëzime. Edhe këtë vit, kurorëzime ka pasur nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin dhjetor, me 18 raste, e përcjell nga muaji gusht me 14 raste, kurse numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar në muajin maj, me 2 raste. Nga numri i këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 29.2 vjeç, dhe gjithashtu është nxjerrë mosha mesatare e femrave me 25.9 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 27. 5 vjeç.

Edhe gjatë vitit 2020, ,nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit e kanë respektuar rregullat ligjore plotësisht.

Gjithnjë, sipas statistikave që janë marrë në Zyrën e Gjendjes Civile të komunës së Kaçanikut ,në vitin 2021, në këtë qytet janë realizuar gjithsejtë; 120 kurorëzime. Edhe këtë vit, kurorëzime ka pasur nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin korrik, me 16 raste, e përcjell nga muajt: gusht dhe tetor, me nga 14 raste, kurse numri me i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar në muajt: maj, përkatësisht shtator me 6 raste. Nga numri i këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 29.6 vjeç, dhe mosha mesatare e femrave me 26.4 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 28 vjeç.

Edhe gjatë vitit 2021, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar normat ligjore plotësisht.

Prej përpunimit të rezultateve në vitin 2022, në qytetin e Kaçanikut janë realizuar gjithsejtë: 144 kurorëzime. Edhe këtë vit, kurorëzime ka pasur nëpër secilën muaj. Numri më i madh i kurorëzimeve është regjistruar në muajin janar, me 18 raste, e përcjell nga muajin tetor me 17 raste, kurse numri më i vogël i lidhjeve të martesave është regjistruar në muajin shtator me 7 raste. Nga numri i këtyre kurorëzime, është nxjerrë mosha mesatare e meshkujve me 29.6 vjeç, dhe mosha mesatare e femrave me 26.4 vjeç. Nga rezultatet e këtij viti, është eksploruar edhe mosha mesatare e kurorëzimeve e cila është 28 vjeç.

Edhe gjatë vitit 2022, nuk kemi ndonjë rast që nuk i ka plotësuar kushtet për lidhjen e martesës dhe vlefshmërinë e saj, çka do të thotë se; të rinjtë e Kaçanikut, edhe këtë vit i kanë respektuar normat ligjore plotësisht.

Duke përfunduar diskutimin e këtij punimi hulumtues të realizuar në qytetin e Kaçanikut, mund të konstatojmë se; në këtë qytet janë realizuar gjithsejtë: 1614 kurorëzime.

Nga analizimi dhe përpunimi i rezultateve për periudhën 2012-2022, në qytetin e Kaçanikut, gjithnjë sipas librit amzë nga; Zyre e Gjendjes Civile, në vitin 2012, ka pasur numër më të madh të të kurorëzuarve, e pasur nga viti 2014, përkatësisht 2019, me 162 raste. Ndërsa, viti me më pak kurorëzime është viti 2020, me 112 raste, e pasuar nga viti 2021, me 120 raste.

Nga prezantimi dhe përpunimi i rezultateve, gjatë kësaj dekade, kurorëzime më së shumti janë regjistruar muajin dhjetor të vitit 2014, me 31 raste dhe në muajin gusht të vitit 2019, me 31 raste, e pasuar nga muaji dhjetor i vitit 2012, me 22 raste. Ndërsa, muajt me më pak kurorëzime janë regjistrua muaji prill i vitit 2014, me 2 raste dhe muaji maj, me 2 raste, përkatësisht nëntor, me 4 raste të vitit 2020. Nga këto analiza dhe statistika, mund të përfundojmë se, të rinjtë e Kaçanikut, nuk kane pasur ndonjë muaj apo sezon të preferuar për të kurorëzuar.

Bibliografia:

1. Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, e Drejta Familjare, Prishtinë 2007
2. Albana Metaj-Stojanova, “Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile” në “Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetovë, 2022
3. Albana Metaj-Stojanova, *Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me Republikën e Shqipërisë*, Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, Tiranë, 2019
4. Albana Metaj-Stojanova, *The fundamental human right to marry and to family life and their protection in the legal framework of the Republic of Macedonia*, in Iliria International Review, Vol. 7, no. 1, Prishtina, 2017
5. Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Tiranë, 2001
6. Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, e Drejta Familjare, Tiranë, 2006
7. Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, e Drejta Romake, Prishtinë 2015
8. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948
9. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2012.
10. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2013,
11. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2014,
12. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2015,
13. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2016,
14. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2017,
15. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2018,
16. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2019,
17. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2020,
18. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2021
19. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme , K. Kaçanik, raporti 2022.
20. Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Mickoviq, Angel Ristov, E Drejta Familjare, Tetovë 2020
21. Hamdi Podvorica, e Drejta e Familjare, Prishtine, 2011
22. Hamdi Podvorica, e Drejta Familjare, Prishtinë 2006
23. Idrizi, N., “Pasojat juridike të shkurorëzimit vështrim krahasues Kosovë-Shqipëri, Prishtinë, 2018
24. Ivo Puhan, e Drejta Romake, Prishtinë, botimi i pestë, 1980
25. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

26. Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile
27. Ligji nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës
28. Ligji Nr.9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes I Republikës së Shqipërisë
29. Ligji për Familjen, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.153, dt. 20.10.2014.
30. Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes,